

RAPORT
I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK

Për Programin e studimit BSc në “Shkenca Kompjuterike”

Universiteti i New York-ut në Tiranë

Ekspertët e vlerësimit të jashtëm:

Prof. Dr. Thoma KORINI

Dr. Alketa GREPCKA



Prill 2019

RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Për Programin e studimit BSc në "Shkenca Kompjuterike"

Tabela e të dhënave për programin e studimit		
1	IAL Aplikues:	Universiteti i New Yorkut në Tiranë
2	Fakulteti që e ofron	Fakulteti i Informatikës / Departamenti i Shkencave Kompjuterike
3	Urdhëri/VKM i licencimit/riorganizimit	Licencuar me VKM Nr. 397, datë 15.08.2002, si program Bachelor. Riorganizimi si Bachelor, me 256 ECTS, me kohëzgjatje 4 vite studimi, me shkresë të MASR nr. 2160/1, datë 23.03.2018
4	Urdhëri/VKA e Akreditimit të parë	UMASh nr. 385, dt. 10.10.2006
5	Titulli i programit të studimit:	Bachelor në Shkenca Kompjuterike
6	Cikli i studimit:	Cikli i parë
7	Kohëzgjatja e programit të studimit:	4 vite
8	Kreditet në total (ECTS):	256 ECTS (128 ACTS)
9	Forma e studimit (me kohë të plotë/të pjesshme/në distancë/):	Me kohë të plotë
10	Gjuha (shqip/tjetër):	Anglisht
11	Programi ofrohet <i>vetëm</i> nga institucioni	JO
12	Programi ofrohet nga institucioni në bashkëpunim me institucione të tjera	PO Në bashkëpunim me Universitetin Shtetëror të New York-ut, Empire State College, (SUNY-ESC) New York, SHBA)
13	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	JO
14	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	PO (Bachelor in Computer Science)
15	Niveli në Kornizën kombëtare të kualifikimeve	Niveli 6
16	Numri i studentëve	158 (të regjistruar në 4 vitet e fundit)

HYRJE

Të dhëna për programin e studimit Bachelor në Shkenca Kompjuterike

Programi i studimit Bachelor në Shkenca Kompjuterike është licencuar me VKM Nr. 397, datë 15.08.2002. Programi Bachelor është shpallur i akredituar me UMASH nr. 385, dt. 10.10.2006, (sipas relacionit të Këshillit të Akreditimit, datë 08.06.2006 "Mendime dhe Rekomandime për Akreditimin e disa diplomave të Universitetit të New York-ut Tiranë (UNYT) ").

Ky program studimi është riorganizuar nga Bsc në Master Profesional me Shkresë nga MAS me Nr. 6858/2 prot, datë 06.05.2011. Programi Master Profesional "Shkenca kompjuterike", me profile: (i) Sisteme të Informacionit; (ii) Shkenca Kompjuterike" është akredituar me Urdhër nr. 384, datë 06.09.2013 mbështetur në Vendimin e Këshillit të Akreditimit Nr. 508, datë 18.07.2013 (Pozitiv me rekomandime).

Programi është riorganizuar si Bachelor, me 256 ECTS, me kohëzgjatje 4 vite studimi, me shkresë të MASR nr. 2160/1, datë 23.03.2018, me emërtimin Bsc në "Shkenca Kompjuterike", bazuar në Vendimet Nr. 26, datë 15.06.2016; Nr. 37, datë 28.07.2017 dhe Nr. 42, datë 23.02.2018 të Senatit Akademik të IAL.

Programi i studimit Bachelor në "Shkenca Kompjuterike" funksionon në bashkëpunim me State University of New York / Empire State College (ESC), dhe një numër studentësh përfitojnë diplomë të dyfishtë.

GRUPI I VLERËSIMIT TË JASHTËM (GVJ)

Përbërja e GVJ:

- Prof. Dr. Thoma KORINI
- Dr. Alketa GREPCKA

Ngritja e Grupit të Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) është bërë nga ASCAL /Bordi i Akreditimit. Koordinatori teknik (KT) i ndjekjes së vlerësimit të kësaj procedure është specialisti i ASCAL, ME. Renata Qatipi.

Më datë 21.03.2019, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare me Nr. 35/25 Prot., datë 21.03.2019 "Njoftim për dërgimin e Draft-Raportit të Vlerësimit të Jashtëm", UNYT është njohur me Draft-Raportin e vlerësimit të jashtëm.

Më datë 25.03.2019, "UNYT" përcjell zyrtarisht përgjigjen për Draft –Raportin, me shkresë Nr. 113/2019 Prot., datë 25.03.2019 "Përgjigje për draft raportin e vlerësimit të jashtëm për programin e studimit Bsc në "Shkenca Kompjuterike, në kuadër të akreditimit periodik".

Në këtë dokument institucioni nuk ka bërë komente për Draft-RVJ dhe është dakort me vlerësimin.

Draft Raporti është edhe Raporti përfundimtar.

ANALIZË PËR PLOTËSIMIN E REKOMANDIMEVE TË DHËNA NGA KA NË VENDIMIN PËR AKREDITIMIN E PARË

I. Rekomandimet e Këshillit të Akreditimit

Në Vendimin e Këshillit të Akreditimit Nr. 508, datë 18.07.2013, janë dhënë këto rekomandime:

- a) **Të bëhen më shumë përpjekje për të rritur numrin e studentëve të pranuar në këtë program studimi.**
- b) **Të përmirësohet kërkimi shkencor për të mos mbetur vetëm në nivel institucional**

- c) **Të rritet numri i personelit mësimdhënës ndihmës.**

II. Plotësimi i tyre nga Institucioni

- a) Për rekomandimin a) UNYT ka ndërmarrë një sërë aktivitete në drejtim të përthithjes së numri më të madh studentësh (që nga takime me maturanët, promovim në rrjete sociale media e panaire, shpërndarje broshurash e fletëpalosjesh informuese rreth programit, ftesë për të ndjekur leksione dhe prezantime pranë UNYT e deri në ofrimin e bursave për studentët e ekselencës). Në këtë mënyrë numri i studentëve ka ardhur duke u rritur për të arritur në mbi dyfishimin e tij krahasuar me vitin akademik 2013-2014.

Rekomandimi është përmbushur.

- b) Për rekomandimin b), UNYT ka ndërmarrë një riorganizim të strukturës së tij. Ngritja e Fakultetit të informatikës dhe integrimi në të i një qendre kërkimore ka fuqizuar kapacitetet kërkimore në përgjithësi në shërbim të programeve të studimit që mbulon ky fakultet e në veçanti në shërbim të programit të studimit Bachelor në Shkenca Kompjuterike. Integrimi edhe i 3 doktorantëve në personelin akademik efektiv kontribon në zhvillimin e punës shkencore të Fakultetit.

Rekomandimi është përmbushur.

- c) Për rekomandimin c), UNYT (edhe për t'ju përgjigjur strukturës së re) ka angazhuar personel akademik duke plotësuar standartin në kufirin minimal prej 7 punonjësish akademikë efektive për çdo njësi bazë të Fakultetit (në total 21, nga të cilët 12 me tituj e grada). Eventualisht, për të garantuar një qëndrueshmëri të personelit duhet synuar një rritje e tij mbi kufijtë minimalë të kërkuar nga standartet.

Rekomandimi është përmbushur.

ADMINISTRIMI I NJËSISË NË SHËRBIM PROGRAMIT TË STUDIMIT

1. Misioni/Objektivat e programit të studimit

Programi Bachelor (4-vjecar) në Shkenca Kompjuterike ofrohet nga Universiteti i New York në Tiranë në bashkëpunim me State University of New York/ Empire State College, SHBA. Bashkëpunimi me State University of New York/ Empire State College është aprovuar deri më 30qershor 2022 [Dok. 9, Aneksi 2.4, Mendim i Dekanit]. Si rezultat i këtij bashkëpunimi, lëshohet diplomë e dyfishtë, dhe studentët e interesuar pajisen me dy diploma, përkatësisht një nga secili universitet.

Misioni dhe objektivat e programit të studimit janë të integruara në misionin dhe objektivat e UNYT i cili synon krijimin, zhvillimin, përcjelljen dhe mbrojtjen e dijeve, si edhe përgatitjen e qytetarëve paraprirës të së ardhmës, profesionistëve dhe akademikeve të ardhshëm me anë të mësimdhënies, të të nxëniet dhe hulumtimit duke i kushtuar rëndësi të veçantë zhvillimit personal dhe integritetit në komunitet, si dhe duke siguruar njohuritë, aftësitë, karakterin dhe besimin e nevojshëm për të patur sukses në një mjedis heterogjen, ndërkombëtar [Dok.4, Aneksi 1, Statuti i UNYT].

Referuar RVB [Dok. 2, RVB faqe 9], programi i studimeve Bachelor në Shkenca Kompjuterike është projektuar për t'ju ofruar studentëve mundësinë për të eksploruar dhe studiuar në fushat e shkencave kompjuterike si dhe të zgjerojë aftësitë e tyre praktike për të ndihmuar studentin në karrierën e tij profesionale. Programi gjithashtu përpiqet të ofrojë njohuri më të gjera dhe më të detajuara, si dhe të kultivojë një qasje të orientuar drejt inovacionit dhe kërkimit shkencor për të ndihmuar studentët e interesuar më tej për një diplomë të mundshme masteri.

UNYT është i angazhuar në zhvillimin intelektual, krijues dhe personal të studentëve të tij dhe konsideron se rezultatet e mësimin duhet të përfshijnë [Evidencë Aneksi 1, Statuti i UNYT]:

- Përvetësimin e aftësive të komunikimit dhe zhvillimit të dijeve me gojë dhe me shkrim në gjuhën angleze.
- Formimin e aftësive të mendimit analitik, sintetik dhe kritik;
- Zhvillimin e metodave të kërkimit shkencor, duke përfshirë aftësinë për të përcaktuar, vlerësuar dhe sintetizuar informacione dhe të dhëna;
- Njohjen e kulturave perëndimore dhe më gjerë duke bërë të mundur analiza krahasimore të shoqërive përkatëse;
- Ndeshmërinë ndaj problemeve sociale dhe diversitetit kulturor dhe etnik.
- Rritjen e njohurive rreth çështjeve ndërkombëtare për arritjen e një perspektive globale;
- Zhvillimin e marrëdhënieve të qëndrueshme ndërpersonale dhe shoqërore;
- Kuptimin, rëndësinë dhe sfidat e përdorimit të teknologjisë moderne;
- Ndërgjegjësimin mbi arritjen e mundësive profesionale dhe kuptimin e etikave dhe përgjegjësisë individuale;
- Forcimin e vlerave të integritetit, objektivitetit për të mundësuar një vetvlerësim real;
- Zhvillimin e aftësive dhe të sjelljeve të nevojshme për t'u bërë ekspertë profesionalë në fushat e studimit;
- Formimin e vlerësimit të trashëgimisë dhe kulturës shqiptare gjatë gjithë programeve të studimit përmes përdorimit të rasteve studimore, të dhënave dhe krahasimeve.

Referuar planit strategjik për vitet 2017-2022 [Dok.14, Aneksi 5.1], zhvillimi i programit të studimeve Bachelor në Shkenca Kompjuterike mbështetet në pesë kolona kryesore:

- Forcimin e bashkëpunimit të suksesshëm me State University of New York/ Empire State College;

- Internacionalizimin e programit të studimit duke tërhequr student të huaj kryesisht nga rajoni i Ballkanit;
- Rritjen e investimeve në infrastrukturën mësimore dhe laboratorët kompjuterikë;
- Përmirësimin e marketingut për një perceptim më të mirë të programit si brenda ashtu edhe jashtë vendit;
- Rritjen e angazhimit të studentëve të ciklit Bachelor në aktivitete kërkimore në shërbim të programit të studimit.

GVJ është i mendimit se misioni dhe objektivat e programit të studimit janë në përputhje me strategjinë afatgjatë të UNYT.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
I - OFRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE	
Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	
<p>Kriteri 3 Programet e studimeve hartohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit;</p> <p>Kriteri 4 Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në atë program, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit;</p> <p>Kriteri 5 Programet e studimeve hartohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;</p> <p>Kriteri 6 Programet e studimeve hartohen në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit.</p>	<p>Misioni dhe objektivat e programit të studimit janë projektuar për t'ju ofruar studentëve mundësinë për të studiuar në fushat e shkencave kompjuterike me qëllim zgjerimin e aftësive të tyre praktike për të avancuar në karrierën e tyre profesionale. Programi gjithashtu përpiqet të ofrojë njohuri më të gjera dhe më të detajuara, si dhe të kultivojë një qasje të orientuar drejt inovacionit dhe kërkimit shkencor për t'u mundësuar studentëve të interesuar një diplomë të mundshme të ciklit të dytë [Dok. 2, RVB faqe 9].</p> <p>Programi i studimit Bachelor në Shkenca Kompjuterike është në përputhje me qëllimet dhe misionin e UNYT [Dok.14, Aneksi 5.1 Strategjia e Zhvillimit të Programit] dhe është hartuar me synimin e plotësimit të nevojave të tregut të punës dhe të zhvillimit ekonomik të vendit [Dok.12, Aneksi 4].</p>
Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve janë përshtatur me strategjinë për zhvillim të institucionit;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë pajisjen me njohuritë bazë, mbi metoda e parime shkencore të përgjithshme;</p> <p>Kriteri 3 Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë dhe formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh në realizimin e misionit dhe qëllimit të institucionit;</p>	<p>Në objektivat e strategjisë afatgjatë UNYT theksohet si mision i tij edukimi i drejtuesve të së nesërme. UNYT [Dok.13, Aneksi 5], [Dok.14, Aneksi 5.1] u ofron studentëve të tij mundësinë për të marrë një diplomë universitare e cilat do t'u ofrojë njohuri, zhërvjelltësi dhe besimin e nevojshëm për të patur sukses në një ambient pune të larmishëm dhe ndërkombëtar si dhe formimin e tyre si qytetarë që kontribuojnë në komunitetin global.</p> <p>Programi i studimit Bachelor në Shkenca Kompjuterike synon dhënie e njohurive të thelluara për një shumëllojshmëri konceptesh, teorish dhe aplikimesh të shkencave kompjuterike si dhe zhvillimin e aftësive për një vlerësim kritik të problematikave të trajtuara [Dok.11, Aneksi 3]. Synohet në identifikimin e problemit, analizën, dizajnimin dhe zhvillimin e një sistemi softueri, zgjidhjen e problemit vlerësimin e cilësisë etj.</p> <p>Bashkëpunimi me State University of New York/ Empire State College, SHBA kontribon për një realizim dhe zhvillim</p>

bashkëkohor të programit të studimit [Dok.35, Aneksi 24].

II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE

Standardi II.1 - Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës.

Kriteri 1 Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës, në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar;

Kriteri 2 Institucioni, për vlerësimin e nevojave të tregut të punës, kryen një studim tregu, i cili përfshin:

- a. mundësitë e punësimit të studentëve në tregun vendas ose atë rajonal, kombëtar e ndërkombëtar;
- b. kërkesat e punëdhënësve;
- c. një parashikim të përafërt për numrin e pritshëm të studentëve që mund të regjistrohen në këtë program;
- d. numrin e të regjistruarve në programe të ngjashme në institucionet simotra.

Programi i studimit Bachelor në Shkenca Kompjuterike është bazuar në tendencat e tregut të punës si brenda ashtu edhe në nivel rajonal apo edhe më gjerë. GVJ konstaton se i kushtohet vëmendje e veçantë orientimit të studentëve drejt aftësimin praktik. Programi i propozuar i studimit favorizon një përgatitje teknike dhe bazë solide në të gjitha fushat e lidhura me shkencën kompjuterike. Megjithëse nuk ka ndonjë studim real tregu, institucioni bazohet në zhvillimet e shpejta të teknologjisë kompjuterike në dekadat e fundit dhe prioritetet kombëtare në këtë drejtim. Strategjia e hartuar e studimit të tregut [Dok.12, Aneksi 4] shërben si një bazë e mirë për identifikimin e problematikave dhe fokusimin në drejtimet dhe aspektet më të ndjeshme që duhet të adresohen nga UNYT si dhe kontribuon në zhvillimin e perspektivave të tashme dhe të ardhshme institucionit.

Gjithashtu, analiza e punësimeve të të diplomuarve në fushën e shkencave kompjuterike, ku të gjithë të diplomuarit janë punësuar në përputhje me diplomën, tregon për një përputhshmëri mjaft të mirë të të punësuarve me kërkesat e tregut të punës [RVB, faqe 67].

Standardi II.2 - Programet e studimeve synojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare dhe interesave kombëtare.

Kriteri 1 Institucioni ofron programe studimesh që nuk bien ndesh me interesat kombëtare;

Kriteri 2 Programet e studimeve synojnë të ndihmojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare.

Programi i studimit Bachelor në Shkenca Kompjuterike jo vetëm që nuk bie ndesh me interesat kombëtare, por kontribon direkt në përgatitjen e specialistëve të cilët me kompetencat e tyre, do të punojnë për zhvillimin e modernizimin e vendit. Në qëllimet strategjike të UNYT përcaktohet ndër të tjera [Dok.13, Aneksi 5, faqe 6]: Rekrutimi, formimi dhe diplomimi i një kontigjenti studentor të larmishëm i cili do të ndikojë në ekonominë dhe shoqërinë shqiptare.

Programi i studimit, megjithëse nuk ka të bëjë direkt me fushën e ruajtjes së vlerave kombëtare, mbështet zhvillimet prioritare të kohës në Shqipëri e më gjerë.

Konkluzionet e vlerësimit:

1. Programi i studimit Bachelor në Shkenca Kompjuterike është në përputhje me aktet ligjore e nënligjore, misionin, objektivat dhe strategjinë e zhvillimit të UNYT si dhe kërkesat e tregut të punës për specialistë të aftë në fushën e shkencave kompjuterike.
2. Rekomandohet realizimi i një studimi të detajuar tregu në përputhje me Strategjinë e studimit të tregut të UNYT.

2. Struktura akademike e Fakultetit/Departamentit (përgjegjës për programin e studimit)

UNYT përbëhet nga tre fakultete:

- Fakulteti i Ekonomisë dhe Biznesit;
- Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Shoqërore;
- Fakulteti i Informatikës.

UNYT ofron programe studimi për të tre ciklet e studimit si dhe realizon kërkim shkencor bazë dhe të aplikuar me anë të njësive përbërëse.

Fakulteti i Informatikës, i krijuar në vitin 2017, që mbulon diplomën Bachelor në Shkenca Kompjuterike, ka në përbërjen e tij tre njësi:


- Departamenti i shkencave kompjuterike;
- Departamenti i informatikës ekonomike;
- Qendra për kërkime të avancuara kompjuterike.

Në periudhën deri në këtë riorganizim Departamenti i shkencave kompjuterike ishte pjesë e Fakultetit të Drejtësisë Artit dhe Shkencave. Departamenti i shkencave kompjuterike është përgjegjës për organizimin e programit të studimeve Bachelor në Shkenca Kompjuterike duke koordinuar edhe bashkëveprimin me Departamente të tjera kontribuese në këtë program studimi.

Riorganizimi dhe struktura aktuale e Fakultetit të Informatikës ka kontribuar në forcimin e strukturës së Fakultetit duke e përputhur atë me standartet, dhe krijuar mundësitë potenciale në rritjen e peshës së kërkimit shkencor dhe bashkëpunimit me partnerë si në institucione brenda, ashtu edhe jashtë vendit.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Struktura akademike e Fakultetit



Fakulteti i Informatikës, për vitin akademik 2018-2019 ka në përbërjen e tij 21 personel akademik efektiv, nga të cilët 12 me tituj e grada, duke plotësuar kushtet minimale numerike të personelit akademik efektiv.

- Të dhëna për Stafin akademik të Departamentit përgjegjës

Departamenti i Shkencave Kompjuterike ka në përbërjen e tij 7 PAE, nga të cilët 4 me tituj e grada. Në këtë mënyrë, edhe për Departamentin, plotësohen kushtet minimale numerike të personelit akademik efektiv.

GVJ është i mendimit se struktura e re e Fakultetit të Informatikës dhe integrimi në të i Departamentit të Shkencave Kompjuterike dhe i Qendrës për Kërkime të avancuara Kompjuterike janë të përshtashme jo vetëm për realizimin e programit të studimit Bachelor në Shkenca Kompjuterike në stadin aktual, por i shërbejnë më mirë edhe zhvillimit perspektiv në fushën e shkencave kompjuterike për të tre ciklet e studimit. Në këtë drejtim GVJ rekomandon që Qendra për Kërkime të Avancuara Kompjuterike, e cila është në hapat e para të

konsolidimit të saj, të luajë një rol më të madh në zgjerimin e aktiviteti shkencor të Fakultetit dhe vënien në shërbim të programeve të ofruara të studimeve.

Duke filluar nga viti akademik 2013 – 2014 personeli akademik i Departamentit të Shkencave kompjuterike ka evoluar si vijon (Tabelat 2 në Aneks):

Viti akademik	Personeli akademik efektiv (PAE)	Personeli akademik me kontratë (PAK)
2013 - 2014	8	15
2014 - 2015	9	8
2015 - 2016	7	7
2016 - 2017	7	4
2017 - 2018	7	6
2018 - 2019	7	7

Vërehet se personeli akademik efektiv, megjithëse i qëndrueshëm në vite, mbetet në kufirin minimal ligjor. Nga ana tjetër, në se i referohemi listës së personelit akademik të Departamentit vërehet se ka ndryshime nga viti në vit përse i përket stafit të përfshirë në të. P.sh., në se i referohemi dy viteve të fundit (pra pas strukturës së re të Fakultetit), vihet re se nga 7 PAE në të dy këto vite, 3 prej tyre janë zëvendësuar në krahasim me vitin e mëparshëm (tabela 2.5 dhe tabela 2.6 në aneks).

3. Personeli akademik dhe personeli mbështetës për programin e studimit

Departamenti i Shkencave Kompjuterike është departamenti përgjegjës për organizimin e programit të studimeve Bachelor në Shkenca Kompjuterike. Për realizimin e këtij programi studimi angazhohet personel akademik i Departamentit të Shkencave Kompjuterike, por edhe nga departamente të tjerë të Universitetit. Gjithashtu Departamenti angazhon një numër lektorësh me kohë të pjesshme (PAK) për të ofruar module specifike të programit.

Qëllimi kryesor i angazhimit të PAK është tërheqja e ekspertizës nga jashtë institucionit për të forcuar profilin ndërkombëtar të programit duke ofruar kryesisht kurse me zgjedhje të cilët konsistojnë në kurse të specializuara të programit [Dok. 2, RVB]. Referuar tabelës 2.6 në aneks, për vitin akademik 2018-2019, nga PAK, dy mbajnë titullin Profesor i Asociuar ndërsa të tjerët mbajnë gradën Doktor dhe një pjesë e tyre janë të punësuar me kohë të plotë në universitete jashtë vendit. Tërheqja e një ekspertize të tillë, e lehtësuar edhe nga zhvillimi i programit në gjuhën angleze, përbën një element pozitiv në realizimin e programit të studimit.

Përse i përket personeli akademik të angazhuar në këtë program studimi, evolucioni i tij duke filluar nga viti akademik 2013-2014 paraqitet si vijon (tabelat 4 në aneks):

Viti akademik	Personeli akademik efektiv (PAE)	Personeli akademik me kontratë (PAK)
2013 - 2014	15	9
2014 - 2015	16	6
2015 - 2016	21	5
2016 - 2017	22	6
2017 - 2018	22	6
2018 - 2019	16	4

Vërehet një qëndrueshmëri e stafit akademik të angazhuar në këto vite si dhe një mbulim i mirë i realizimit të programit të studimit nga personel akademik efektiv. Gjithashtu, duke krahasuar të dhënat e dy viteve të fundit

(megjithëse për vitin akademik 2018-2019 disponohen vetëm të dhënat për semestrin e vjeshtës), vërehet se ka qëndrueshmëri të stafit akademik të angazhuar në këtë program studimi.

Referuar të dhënave të RVB [Dok.2] si dhe të dhënave të mara gjatë vizitës në UNYT (e që në mënyrë të detajuar pasqyrohen në anekse) rezulton se numri i studentëve për pedagog në total apo për pedagog efektiv (PAE) është i përshtatshëm për zhvillimin normal të programit të studimit.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Numri i Personelit Akademik Efektiv (PAE) dhe Personelit Akademik me Kontratë (PAK), titujt/gradat Përsa i përket kualifikimit të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi, rezultatet për vitet 2013-2019 paraqiten në Tabelat 5.1-5.4.

GVJ është i mendimit se personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi, ka kualifikimin e duhur për të zhvilluar një proces mësimor cilësor dhe në përputhje me standartet.

Të dhëna sipas moshës së personelit

Referuar të dhënave të moshës së personelit akademik për vitin akademik 2018-2019 (Tabelat 6/1 dhe 6/2 në aneks), rezulton se rreth 56% e personelit akademik efektiv i korresponon moshës nga 36 në 45 vjeç, 19% moshës nga 25 në 35 vjeç dhe vetëm 25% i korresponon moshës mbi 45 vjeç. Ndërsa për personelin akademik me kontratë 50% i korresponon moshës nga 25 në 35 vjeç dhe nga 25% për moshat nga 36 në 45 vjeç dhe mbi 45 vjeç.

GVJ është i mendimit se moshja e personelit akademik, si atij efektiv dhe atij me kontratë, garantojnë realizimin cilësor aktual dhe perspektiv të programit të studimit Bachelor në Shkenca Kompjuterike.

Kontratat e punës, njohja me detyrat dhe të drejtat

Personeli akademik i UNYT është i angazhuar në bazë të kontratave të rregullta të punës në përputhje me legjislacionin në fuqi. Zyra e Burimeve Njerëzore menaxhon procesit e punësimit të personelit akademik efektiv dhe atij me kontratë duke mbajtur gjithë dokumentacionin përkatës. Gjatë vizitës në këtë zyrë, GVJ u njoh me procedurat e ndjekura të punësimit si dhe dokumentacionin përkatës. Procedura e ndjekur paraqitet si vijon [Dok. vizita në institucion]:

- Identifikimi i nevojave të Departamentit, diskutimi dhe vendimmarrja në nivel Senati e Rektorati;
- Botimi i njoftimit i cili përfshin profilin e kërkuar të kandidatit. Ky botim realizohet në faqen web të institucionit, në portalet e punimit si dhe në shtypin e shkruar.
- Pranohen aplikimet nga Zyra e Burimeve Njerëzore;
- Ngrihet komisioni me tre personash (staf akademik, Përgjegjës Departamenti/Dekan);
- Shikohet përputhshmëria me kriteret (eliminohen aplikimet jashtë kriterëve);
- Shqyrtohen referencat për eksperiencat e kandidatëve;
- Realizohet intervista;
- Eventualisht mund të vendoset dëgjimi i një leksioni të hapur.
- Merret vendimi i rekrutimit;
- Kandidati merr ofertën financiare dhe vazhdohet me Zyrën e Burimeve Njerëzore për aspektet teknike (nënshkrimi i kontratës, plotësimi eventual i dokumentacionit etj.);

E njejta procedurë ndiqet edhe për rekrutimin e personelit akademik me kontratë.

Problematika e ndjekur nga Zyra e Burimeve Njerëzore, përveç elementëve që lidhen me njoftimet, plotësimin e dosjeve dhe kontratat ka të bëjë edhe me përditësimin e dosjeve të personelit akademik të UNYT. Gjithë dosjet mbahen në format elektronik (krahas formatit letër).

GVJ verifikoi dy dosje të PAE dhe një dosje PAE dhe gjeti në to të pasqyruar dokumentacionin e kërkuar dhe procedurën e punësimit [Dok. vizita në institucion].

Cilësia e stafit ndihmës/ administrativ

Sipas RVB dhe nga konstatimet gjatë vizitës në vend, nga pikëpamja administrative, programi mbështetet nga zyra të tjera të tilla si Zyra e Regjistrave, Zyra e TI-së, zyra e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Çështjeve Operacionale. Në mënyrë të veçantë zyra e TI, që ka në përbërje 3 persona, është e një ndihmese të madhe për mbështetjen e procesit mësimor në laboratorët përkatës informatikë.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
III - PERSONELI I INSTITUCIONIT	
Standardi III.1 - Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit dhe vlerësimit të personelit.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit të personelit në përputhje me statutin dhe rregulloren;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë përbën së paku 70% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të parë;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të vlerësimit të personelit;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni mban një bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit të personelit, të njoftimeve për punë, etj.</p>	<p>UNYT ndjek procedura ligjore për punësimin e personelit akademik efektiv dhe me kontratë. Kriteret shpallen publikisht dhe përzgjedhja bëhet me konkurs shoqëruar me intervistim të kandidatëve [Dok. vizita në institucion].</p> <p>Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë përbën mbi 70% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programit të studimit Bachelor në Shkenca Kompjuterike. Po ashtu, përsa i përket ngarkesës mësimore vërehet se mbi 70% e saj realizohet nga personel akademik efektiv [Dok. Ngarkesa mësimore 2016-2017, 2017-2018, 2018-2019]. Kjo situatë paraqitet e qëndrueshme për 6 vitet e fundit akademike.</p> <p>Përsa u përket lëndëve të mbuluara nga stafi akademik, numri i tyre mesatarisht zhvillohen 6 lëndë për PAE, por ka edhe raste kur një PAE mbulon deri në 8 apo 9 lëndë [Dok. Ngarkesa mësimore 2016-2017, 2017-2018, 2018-2019].</p> <p>Gjatë shqyrtimit të DVV dhe vizitës në institucion GVJ konstatoi se UNYT ndjek procedura ligjore dhe transparente të vlerësimit të personelit. Për pedagogët, kryhet vlerësim nga studentët [Dok.39, Vlerësimi nga studentët], nga pedagogët e Departamentit dhe nga Përgjegjësi i Departamentit [Dok.41, Vlerësimi nga pedagogët].</p> <p>Zyra e Burimeve Njerëzore ka një bazë të dhënash elektronike për të gjithë procesin e rekrutimit të personelit dhe dokumentacionin përkatës.</p>
Standardi III.2 - Institucioni disponon një bazë të dhënash për personelin e tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni disponon një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon listën e plotë të personelit akademik për secilin semestër, të personelit ndihmës</p>	<p>Gjatë vizitës në Zyrën e Burimeve Njerëzore rezultoi se UNYT ka një bazë të dhënash elektronike të hollësishme për anëtarët e personelit akademik [Dok. vizita në institucion].</p> <p>UNYT disponon një informacion të përditësuar për personelin akademik. Për çdo vit akademik përcaktohet safi akademik që do</p>

<p>mësimor-shkencor dhe atij administrativ;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni publikon kriteret dhe procedurat e rekrutimit të personelit akademik;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni angazhon si titullarë të lëndëve/moduleve për programet e studimeve të ciklit të parë, personel akademik që ka së paku gradën shkencore “Doktor,, ose titullin akademik “Docent,,.</p>	<p>të angazhohet (i ndarë sipas semestrave) dhe lidhen kontratat me PAK.</p> <p>Kriteret dhe procedurat e rekrutimit të personelit akademik bëhen publike kur vendoset shpallja për pozicion pune të lirë (shpallen nëpërmjet Portaleve të Punësimit, faqes web të UNYT dhe shtypit të shkruar).</p> <p>UNYT angazhon kryesisht si titullarë të lëndëve, moduleve personel akademik i cili minimalisht ka gradën shkencore Doktor, por ka dhe raste në të cilët titullari i lëndës ka gradën MSc [Dok. syllabuset e lëndëve].</p>
<p>Standardi III.3 - Institucioni angazhon personel ndihmës mësimor shkencor dhe administrativ për përmbushjen e misionit të tij.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni dëshmon një angazhim optimal të personelit ndihmës mësimor-shkencor për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve shkollore;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni vë në dispozicion personel të mjaftueshëm për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale (së paku 1 tutor/instruktor për 12 studentë).</p>	<p>Nga shqyrtimi i DVV dhe vizitës në institucion rezultoi se personeli ndihmës akademik i angazhuar për zhvillimin e seancave praktike ka kualifikimin e duhur dhe punon jo vetëm në mbështetje të realizimit të procesit mësimor, por edhe për mirëmbajtjen e bazës laboratorike e cila është një bazë laboratorike bashkëkohore. Menaxhimi i bazës laboratorike realizohet nga Zyra e TI e cila garanton funksionimin e paisjeve kompjuterike dhe të softuerëve përkatës në shërbim të procesit mësimor dhe kërkimit.</p> <p>Personeli akademik është i angazhuar për përmbushjen e objektivave të programit të studimit.</p>
<p>Standardi III.4 - Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe të mëtejshëm të personelit të tij.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni organizon programe specifike për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon një bazë të dhënash të programeve të studimeve të ofruara.</p>	<p>UNYT i kushton vëmëndje përgatitjes së stafit. Janë organizuar seminare [Dok. vizita në institucion] disa ditore për pedagogët e rinj për t’u njohur me metodologjinë e mësimdhënies [Dok.72, Faculty Development Workshops]. Këto seminare zhvillohen zakonisht çdo semestër.</p> <p>UNYT ka të dhëna të plota për programet e studimeve të ofruara prej tij. Në këtë drejtim një rol të rëndësishëm informimi luan faqja e internetit e institucionit (http://unyt.edu.al/index.php/bachelor-programs/computer-science/) e cila jep informacionin bazë për gjithë programet e ofruara të studimit dhe në veçanti për programin e studimit Bachelor në Shkenca Kompjuterike.</p>
<p><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. UNYT ndjek procedura ligjore për punësimin e personelit akademik efektiv dhe me kontratë; 2. Personeli akademik i Departamentit ashtu edhe personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi, kanë kualifikimin e duhur për të zhvilluar një proces mësimor cilësor dhe në përputhje me standartet; 3. Institucioni angazhohet në kualifikimin e stafit si në aspektet shkencore ashtu edhe në ato lidhur me metodologjinë e mësimdhënies; 4. Ngarkesa mësimore e personelit akademik efektiv është përgjithësisht në një interval të pranueshëm, por do të rekomandonim reduktimin e saj për të mundësuar rritjen e angazhimit në kërkim shkencor. 	

4. Infrastruktura në funksion të programeve të studimit, logjistika dhe shërbime të tjera ndaj komunitetit

UNYT disponon ambientet e nevojshme për zhvillimin e aktivitetit të tij. Sipas RVB [Dok. 2] dhe konstatimeve gjatë vizitës në institucion [Dok. vizita në institucion] ndërtesa kryesore e UNYT ofron hapësirë të mjaftueshme për të mbajtur leksione dhe aktivitete të tjera që lidhen me programet e studimit të ofruara.

Nga vëzhgimi i ambienteve, GVJ konstaton se ato janë të përshtatshme dhe të mjaftueshme për zhvillimin e procesit mësimor. Sallat e leksioneve janë të paisura me mjetet e nevojshme didaktike si videoprojektor, ekrane projektimi etj. Mënyra e realizimit të mësimdhënies bazohet në metoda e teknologji bashkëkohore.

Në veçanti, për programin Bachelor në Shkencat Kompjuterike, janë vënë në dispozicion tre laboratorë që mund të shfrytëzohen për kurse që kërkojnë pajisje kompjuterike si inxhinieri software, bazat e të dhënave dhe rrjetat kompjuterike [Dok. vizita në institucion].

Një nga laboratorët është e pajisur me të gjitha pajisjet Cisco të nevojshme për zhvillimin e lëndëve që lidhen me rrjetet kompjuterikë. Të gjithë laboratorët e tjerë të kompjuterave kanë pajisje të avancuara që mbështesin platformat e avancuara softuerike, të nevojshme për ofrimin e programit Bachelor.

Biblioteka ofron mjedise të mjaftueshme për studim si dhe plotësohet me ambiente të dedikuara për studentët që zhvillojnë takime për projekte të ndryshme [Dok. vizita në institucion]. Biblioteka e cila funksionon në orarin 9.00 - 21.30 nga e hëna deri të premten, në orarin 9:00 – 17:00 ditën e shtunë dhe në orarin 9:00 – 18:00 ditën e diel, ofron një numër titujsh të madh për të mbuluar programin e studimit të ofruar.

Gjithashtu, studentët mund të shfrytëzojnë hapësira sportive moderne në kampus, të cilat gjithashtu mund të përdoren për lloje të tjera aktiviteteve si panairë, shfaqje, etj.

E gjithë hapësira e kampusit mbulohet nga Wi-fi dhe aksesit në internet ofrohet në të gjitha klasat, laboratorët, në bibliotekë etj..

UNYT disponon një sistem qëndror ngrohjeje dhe ftohjeje krijon kushte të përshtatshme për mësimdhënie, studim dhe kërkim shkencor.

Në aneks (tabela 7) paraqiten në mënyrë të detajuar mjediset për programin e studimit dhe mjediset për stafin.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përbushja e standardeve
V - INSTITUCIONI OFRON SHËRBIME DHE VË NË DISPOZICION TË STUDENTËVE BIBLIOTEKA DHE BURIME TË TJERA INFORMACIONI	
Standardi V. 1- Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën e tij.	
Kriteri 1 Institucioni vë në dispozicion të studentëve tekste mësimore dhe literaturë ndihmëse të mjaftueshme në sasi dhe cilësore;	Gjatë takimit me stafin akademik dhe studentët, GVJ konstatoi se pedagogët u rekomandojnë studentëve tekste mësimore që shërbejnë si literaturë bazë si dhe leksione dhe materiale të tjera ndihmëse [Dok. vizita në institucion]. Zhvillimi i programit në gjuhën angleze lehtëson paisjen dhe disponimin e literaturës bazë të nevojshme për zhvillimin e lëndëve. Nga takimet rezulton se për të gjithë lëndët e zhvilluara disponohet literatura bazë.
Kriteri 2 Në bibliotekë ka literaturë të mjaftueshme që e ndihmon studentin për realizimin me sukses të programit të studimit;	
Kriteri 3 Në bibliotekë ka botime periodike dhe programe kompjuterike, si libraritë elektronike, të cilat përmbajnë libra apo revista shkencore të nevojshme për realizimin me sukses të programit të studimit;	
Kriteri 4 Përgjegjësit e programit hartojnë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programit, përfshirë edhe buxhetin e planifikuar për të;	
Kriteri 5 Biblioteka shpall oraret e shërbimit në përshtatje	

me oraret e programit të studimit dhe nevojat e studentëve.	shumë mirë zhvillimin e programit. Nga vizita në institucion konstatohet se biblioteka ofron mjedise të mjaftueshme për studim si dhe ambiente të dedikuara për studentët që zhvillojnë takime për projekte të ndryshme [Dok. vizita në institucion]. Biblioteka funksionon në orarin 9.00 - 21.30 nga e hëna deri të premten, në orarin 9:00 – 17:00 ditën e shtunë dhe në orarin 9:00 – 18:00 ditën e diel duke ofruar kushte pune shumë komode.
---	---

Standardi V. 2- Institucioni vë në dispozicion të studentëve laboratorë dhe mjedise të përshtatshme mësimore dhe për formimin praktik.

Kriteri 1 Institucioni dëshmon se ka në sasi të mjaftueshme: laboratorë, klasa, zyra, studio e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e programit të studimeve;

Kriteri 2 Pajisjet e mjediseve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit;

Kriteri 3 Laboratorët përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të programeve të studimeve;

Kriteri 4 Institucioni, në varësi të programeve të studimeve që ofron, ka së paku një laborator.

Kriteri 5 Institucioni, në varësi të programeve të studimeve, disponon kompjutera në laboratorët e teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale si programe për statistikë, linguistikë, arkitekturë, inxhinieri, ekonomi, mjekësi, programestimulimi për shkencat sociale etj.

Kriteri 6 Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset janë të mjaftueshme për zhvillimin e praktikave profesionale.

UNYT ka një infrastrukturë të mjaftueshme dhe cilësore për zhvillimin e procesit mësimor.

Sallat e leksioneve janë të paisura me mjetet e nevojshme didaktike si videoprojektor, ekrane projektimi etj. Mënyra e realizimit të mësimdhënies bazohet në metoda e teknologji bashkëkohore [Dok. vizita në institucion].

Për programin Bachelor në Shkencat Kompjuterike, janë vënë në dispozicion tre laboratorë që mund të shfrytëzohen për kurse që kërkojnë pajisje kompjuterike si inxhinieri software, bazat e të dhënave dhe rrjetat kompjuterike [Dok. vizita në institucion].

Një nga laboratorët është e pajisur me të gjitha pajisjet Cisco të nevojshme për zhvillimin e lëndëve që lidhen me rrjetat kompjuterikë. Të gjithë laboratorët e tjerë të kompjuterave kanë pajisje të avancuara që mbështesin platformat e avancuara softuerike, të nevojshme për ofrimin e programit Bachelor.

Në kuadrin e procesit mësimor nuk janë parashikuar në mënyrë eksplicite praktika mësimore, por aspektet praktike të lëndëve të ndryshme trajtohen në laboratorët e UNYT. Nga ana tjetër realizohen kontakte (nëpërmjet pedagogëve) me biznese të ndryshme të fushës duke planifikuar edhe pjesë të kohës së studentit në këto biznese [Dok. vizita në institucion].

Konkluzione të GVJ:

- 1- Mjediset janë të përshtatshme dhe me hapësira funksionale për zhvillimin e të gjitha veprimtarive universitare. Infrastruktura që është në dispozicion të zhvillimit të procesit mësimor plotëson standartet dhe kriteret e cilësisë.
- 2- Godina, disponon një infrastrukturë moderne. Sallat e leksioneve janë të paisura me videoprojektor. Laboratorët e informatikës janë të paisur me programet e nevojshme të përcaktuar në programin mësimor. Laboratorët mësimorë janë të kompletuar duke u paraqitur me pajisje të reja bashkëkohore për zhvillimin cilësor të seancave praktike.
- 3- Biblioteka, ka një kapacitet të mjaftueshëm dhe ofron kushte të mira si për studim ashtu edhe për punë eventuale në grup. Fond i botimeve ka ardhur duke u pasuruar duke mbuluar plotësisht lëndët jo vetëm me literaturën bazë, por edhe me atë ndihmëse. Veç kësaj mund të shfrytëzohen edhe bibliotekat on-line si dhe libraritë elektronike të cilat përmbajnë libra apo botime shkencore në drejtim të shkencave kompjuterike.

5. Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare

Referuar RVB [Dok. 2], pranë UNYT funksionon Zyra e Financës e cila e ngarkuar me zbatimin e politikës financiare të institucionit. Burimet financiare të universitetit janë kryesisht nga tarifat e shkollimit. Të gjitha këto të ardhura shkojnë për rritjen e kapaciteteve dhe përmirësimin e strukturave menaxhuese.

UNYT kryen auditime të brendshme dhe të jashtme në baza vjetore.

Në mënyrë të përmbledhur për 6 vitet e fundit këto të ardhura paraqiten në tabelën 8.1 në aneks, ndërsa të shprehura në përqindje sipas burimeve të të ardhurave paraqiten në tabelën në vijim:

Të ardhurat nga:	Viti 2012 (%)	Viti 2013 (%)	Viti 2014 (%)	Viti 2015 (%)	Viti 2016 (%)	Viti 2017 (%)
Grantet për kërkim dhe kontratat	0.7	0.1	0.7	4.4	4.6	5.5
Tarifat për dhe gjatë shkollimit	98.9	99.6	99.0	95.0	95.1	94.5
Aktivitetet tregtare (mensa, kafe, bare, residencat, etj)	0.4	0.4	0.3	0.7	0.3	0.0
<i>SHUMA</i>	100	100	100	100	100	100

Siç shihet nga tabela e mësipërme burimi kryesor i financimit janë tarifat për dhe gjatë shkollimit të cilat luhaten nga 94.5 deri në 98.9%. Megjithatë në se shihet evolucioni në vite shihet se ka një tendencë të lehtë rritjeje në të ardhurat nga grantet për kërkim dhe kontratat, nga një shumë e papërfillshme (0.7%) në vitin 2012 në rreth 5.5% në vitin 2017.

Në se i referohemi tabelës 8.2 në aneks, vërehet se rreth 45-55% e të ardhurave i dedikohen pagave, pjesa tjetër, rreth 41-49% shpenzimeve operative, ndërsa investimet shifrohen në më pak se 10% (maksimumi prej 10 % i korrespondon transferimit të UNYT në ambientet aktuale, ndërsa minimumi 1%).

Referuar RVB [Dok. 2, faqe 35], në fund të çdo viti akademik UNYT bën një analizë të kostos për të gjitha programet e studimeve. Analiza e kostos së programeve shqyrtohet në raport me të ardhurat e gjeneruara nga programet. Analiza e fitimit / humbjes kryhet për secilin program dhe nëse është e nevojshme modifikimet e duhura të komponentëve të caktuar të kostos bëhen për vitin e ardhshëm akademik [RVB, faqe 35].

Kostua për student është mesatarisht rreth 5000 Euro/student për diplomën e dyfishtë me ESC dhe rreth 3400 Euro/student për diplomën lokale Bachelor në Shkenca Kompjuterike.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE	
Standardi II.5 - Institucioni vlerëson dhe dokumenton gjendjen e tij financiare.	
Kriteri 1 Institucioni bën një auditim të përvitshëm (të jashtëm ose të brendshëm) të situatës financiare të tij;	UNYT kryen auditime të brendshme dhe të jashtme në baza vjetore [Doc.57, Internal Finance Auditing 2015-2016], [Doc.53, The external auditing report for the financial year 2017]. Auditimi i brendshëm kryhet nga Komisioni i emëruar nga bordi i aksionerëve të Universitetit, ndërsa auditimi i jashtëm kryhet nga një kompani e pavarur auditimi që kryen veprimtarinë e saj në Shqipëri.
Kriteri 2 Në raportin e auditit paraqiten të gjitha detyrimet financiare, pagat e personelit, shpenzimet operative, etj;	
Kriteri 3 Raporti i auditit përmban një pasqyrë të qartë të granteve të huaja të përfituara dhe kontratave të shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimeve të ciklit të parë.	
VI - BURIMET FINANCIARE DHE VLERËSIMI FINANCIAR	

Standardi VI.1 - Institucioni harton një raport financiar të kostove të programeve të studimeve.

Kriteri 1 Institucioni harton një raport financiar që përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare;

Kriteri 2 Institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike;

Kriteri 3 Institucioni dëshmon një qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.

Në fund të çdo viti akademik University of New York Tirana kryen analizën e të ardhurave dhe të kostove të programeve të studimit [Dok.56, Raporti Vjetor 2017-2018].

UNYT dëshmon një qëndrueshmëri financiare gjatë 6 viteve të fundit të zhvillimit të programit të studimeve BSc në Shkenca Kompjuterike.

Eventualisht, në të ardhmen, mund të punohet në drejtim të diversifikimit të burimeve të financimit.

Konkluzionet e vlerësimit:

1. Në mënyrë të përvitshme hartohet një raport financiar që përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave dhe shpenzimeve;
2. Çdo vit, UNYT bën një auditim të jashtëm për sa i përket situatës financiare;
3. Duke iu referuar raportit financiar zyrtar UNYT ka një bilanc vjetor pozitiv, i cili garanton ecurinë perspektive të programeve të studimit;
4. Konstatohet qëndrueshmëri financiare e UNYT, por eventalisht mund të punohet në drejtim të diversifikimit të burimeve të financimit.

6. Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë

Mbështetur në dokumentacionin e RVB [Dok. 2, faqe 39], dokumentacionin mbështetës të AMS dhe gjatë vizitës në institucion [Dok. vizita në institucion] rezultojnë se: "Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë" është ngritur dhe funksionon në përputhje me kërkesat e legjislacionit shqiptar mbi arsimin e lartë si dhe dispozitat e Statutit të UNYT.

Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë në UNYT funksionon nëpërmjet Komisionit të Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë të Institucionit.

Komisioni për Garantimin e Standardeve të Cilësisë së Institucionit (KoGaSCI) [Dok.4, Statuti i UNYT, Neni 28] zgjidhet nga Senati Akademik me misionin e zhvillimit dhe forcimit të sistemit të cilësisë në UNYT, duke i shërbyer nevojave të komunitetit të universitetit dhe organeve të interesuara që lidhen me cilësinë e institucionit dhe të programeve të studimit të ofruara nga UNYT. Ky Komision:

- është përgjegjës për koordinimin e procedurave të përgjithshme të vlerësimit të brendshëm dhe të jashtëm të njësive akademike, të kërkimit shkencor dhe të vetë universitetit;
- mbikëqyr dhe zhvillon rregulloret, politikën, programet, proceset akademike dhe jo-akademike;
- garanton pajtueshmërinë me kuadrin ligjor duke siguruar cilësinë në UNYT në bashkëpunim me të gjithë palët e interesuara.

Vlerësimi i brendshëm i strukturave dhe programeve të studimit kryhet periodikisht sipas përcaktimeve të Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë. KoGaSCI ndërmjetëson, harton dhe raporton aktivitetet e iniciativave të reja lidhur me sigurimin e cilësisë në të gjitha njësitë e UNYT nëpërmjet Koordinatorit të Garantimit të Cilësisë.

Komisioni i përhershëm përbëhet nga drejtori dhe 5 anëtarë (nga një për çdo fakultet, një ekspert i jashtëm dhe një përfaqësues i studentëve) [RVB Dok. 2, faqe 39].

Në mbështetje të procesit të sigurimit të cilësisë ka qenë dhe pjesëmarrja e UNYT si partner në projektin Erasmus +: QainAL -"Mbështetje Strategjike për Forcimin e Strukturave të Sigurimit të Cilësisë në

Institucionet Private të Arsimit të Lartë në Shqipëri", projekt fokusohet në krijimin dhe mbështetjen e proceseve për sigurimin e cilësisë dhe mekanizmeve për sigurimin e menaxhimit efektiv dhe përmirësimin e mësimdhënies dhe të nxënies në institucionet private të arsimit të lartë në Shqipëri. Angazhimi në këtë projekt dhe trajnimet e marra, i kanë shërbyer UNYT në përmirësimin e praktikave të sigurimit të cilësisë.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Të dhëna sasiore për punën konkrete në NJSBC për programin e studimit

Realizohen 2 anketime në vit me studentët për secilën lëndë që ofrohet çdo semester dhe nga një anketim për çdo lëndë që ofrohet vetëm një herë në vit. Përgjithësisht anketimet kryhen pas provimit të mesit të semestrit (pas mid-term) [RVB Dok. 2], [Dok. vizita në institucion].

Gjatë 5 viteve të fundit për programin e studimeve BSc në Shkenca Kompjuterike kanë marrë pjesë një numër studentësh sipas tabelës në vijim [Dok.58, Vlerësime te kryera nga Studentët e Bachelor ne Shkenca Kompjuterike]:

Programi	Vitet				
	2013-2014	2014-2015	2015-2016	2016-2017	2017-2018
Shkenca Kompjuterike (Nr.Studentëve)	70	70	130	190	200

Vihet re një rritje nga viti në vit e numrit të studentëve që marrin pjesë në vlerësim, gjë që dëshmon për rritjen e ndërgjegjësimit për problemet e cilësisë.

Të gjithë të dhënat e mbledhura nga pyetësorët përpunohen dhe nga analiza e tyre ka rezultuar se, në përgjithësi, studentët janë shprehur pozitivisht.

Rezultatet e vlerësimit i transmetohen pedagogut dhe Përgjegjësit të Departamentit. Problematika ndiqet nga ana e Departamentit eventualisht edhe në rrugë administrative [Dok. vizita në institucion].

Përveç pyetsorit të studentit UNYT përdor dhe forma të tjera të vlerësimit të punës së pedagogut si [Dok. vizita në institucion, faqe 20]:

- Vlerësimi nga kolegët e departamentit (sipas një formulari tip) [Dok.41, Peer Evaluation of Teaching Form];
- Vlerësimi i performancës individuale të pedagogut ku mbi bazën e indikatorëve vjetorë ballafaqohet panifikimi i aktivitetit vjetor të PAE me realizimin.

Përgjegjësi i Departamentit harton një raport vjetor lidhur me gjithë aktivitetin e departamentin në të cilin pasqyrohet aktiviteti i departamentit në trajtën e objektivave dhe arritjeve, shoqëruar edhe me një analizë SWOT [Dok.59 Annual Monitoring Report 2017-2018].

Kontrolli i brendshëm i cilësisë

Përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë është një nga objektivat parësorë të institucionit. Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë koordinon edhe zhvillimin e një numri aktiviteteve si [Dok. vizita në institucion]:

- Transparenca e notës (mund të verifikohen edhe fletoret e provimeve);
- Monitoron Sekretainë Mësimore (hedhjen e notave etj.);
- Ndjek rekomandimet e dhëna nga akreditimi;
- Harton plan veprimi për përmirësimin e pikave të dobta;

- Transmeton rezultatet që kanë të bëjnë me monitorimin e cilësisë në ESC;
- Ndjek problematikat e shprehura nëpërmjet peticionit akademik;
- Monitoron rishkrimin e syllabuseve nga departamentet (sidomos përpuethshmërinë me ndryshimet ligjore);
- Kontribon në njohjen e stafit të ri me metodologjinë e mësimdhënies (organizim seminaresh);
- Kontribon në rishikimin e pyetsorëve;
- Hartimin e një raporti semestral e vjetor të aktivitetit.
- Etj.

Dokumentacioni bazë dhe korrent i kësaj njësie vendoset në një sharefolder për të mundur aksesimin nga të interesuarit.

Përgjegjësitë në monitorimin dhe menaxhimin e cilësisë deri në nivel departamenti

Krahas vlerësimeve të përmendura më sipër, departamenti punon në vazhdim për përmirësimin e cilësisë së ofertës akademike. Duke qenë se modeli i zgjedhur është ai i SUNY-ESC dhe se një pjesë e studentëve ndjekin diplomën e dyfishtë, programi i studimeve BSc. në Shkenca Kompjuterike është në monitorim të vazhdueshmë edhe nga SUNY-ESC dhe punohet mbi bazën e syllabuseve të unifikuara [Dok. vizita në institucion]. Për shumë çështje në lidhje me programin, kërkohet një konsultim dhe miratim nga partneri SUNY-ESC [Dok.34, Vlerësim nga ana e SUNY-ESC i ndryshimeve në kurrikulumin e BSc në Shkenca Kompjuterike].

Bazuar në Raportin e Vlerësimit të Brendshëm dhe në gjëndjen e konstatuar gjatë vizitës, UNYT ka politika të qarta të vlerësimit të mbështetura në standartet e cilësisë. Nuk u evidentuan ndryshime ndërmjet të dhënave të deklaruara dhe atyre të konstatuara.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE	
Standardi II.3 - Institucioni, për akreditimin e programeve të studimeve, përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e tyre.	
<p>Kriteri 1 Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni publikon rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe rezultatet që synon të arrijë;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni, për kryerjen e vlerësimit, përdor metoda të tërthorta ose të drejtpërdrejta:</p> <p>Të tërthorta:</p> <ol style="list-style-type: none"> Sondazhe: të studentëve që ndjekin programet e studimeve, të të diplomuarve; Sondazhe të vlerësimit të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit; Pyetje konceptuale; Intervista; Etj. <p>Të drejtpërdrejta:</p> <ol style="list-style-type: none"> Teste të standardizuara kombëtare/ndërkombëtare (p.sh. provimi i shtetit për profesionet e rregulluara); Dëgjime në auditor; Vlerësimi me nota/pikë; 	<p>Nga shqyrtimi i DVV dhe takimin me përfaqësuesit e ZSBC, GVJ konstaton se, UNYT përdor metodologji vlerësimi për ecurinë e programeve të studimeve të cilat përbëhen nga:</p> <ul style="list-style-type: none"> - vlerësimet e studentëve në bazë lënde; - vlerësimet e kolegëve/përgj.departamentit; - vlerësimi i performancës individuale të pedagogut. <p>Përgjegjësi i Departamentit harton një raport vjetor lidhur me gjithë aktivitetin e departamentin në të cilin pasqyrohet aktiviteti i departamentit në trajtën e objektivave dhe arritjeve, shoqëruar edhe me një analizë SWOT [Dok.59, Annual Monitoring Report 2017-2018]</p> <p>ZSBC koordinon aktivitete dhe përcakton detyra, zbatimin e të cilave ndiqet nga ana e strukturave përkatëse si dhe nga vetë ZSBC. Informacioni i përftuar, e që menaxhohet nga ZSBC, bëhet pjesë edhe e raporteve të vetëvlerësimit duke</p>

<p>d. Testime paraprake dhe përfundimtare; provime për module, praktikë;</p> <p>e. Vlerësimi i detyrave të kryera nga studentët (detyra kursi për të analizuar të kuptuarit konceptual, provimet, referatet);</p> <p>f. Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës;</p> <p>g. Etj.</p>	<p>kontribuar në përmirësimin e cilësisë.</p> <p>ZSBC menaxhon edhe rekomandimet që jepen nga partneri SUNY-ESC për përmirësimin e elementëve apo procedurave që lidhen me përmirësimin e cilësisë.</p>
---	---

VIII - INSTITUCIONI GARANTON SIGURIMIN E CILËSISË

Standardi VIII.1 - Institucioni garanton sigurimin e cilësisë në realizimin e programeve të studimeve.

<p>Kriteri 1 Institucioni ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional përpara aplikimit për akreditimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni harton një politikë të qartë dhe ndjek procedurën e vlerësimit periodik të efikasitetit të veprimtarive që kryen për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të studimeve që ofron;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni përdor mekanizma formalë për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve që ofron;</p> <p>Kriteri 5 Institucioni synon ndërgjegjësimin e personelit të vet dhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve që ofrohen për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë në to;</p> <p>Kriteri 6 Institucioni harton dhe zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Strategjia, politika dhe procedurat janë publikuar.</p>	<p>UNYT është akredituar institucionalisht për herë të parë në vitin 2006 dhe u riakreditua në nivel institucional në vitin 2015.</p> <p>Gjithashtu UNYT u riakreditua institucionalisht në kuadër të bashkëpunimit të ASCAL me Agjensinë Britanike QAA me vendim Bordit të Akreditimit Nr. 102, dt.10.11.2017.</p> <p>Politikat dhe procedurat për sigurimin e cilësisë janë të shpallura në Statutin, planin Strategjik të UNYT, dhe janë detajuar në Manualin e Sigurimit të Cilësisë të institucionit [Dok.20, Quality Assurance Manual]. Ky i fundit siguron të gjitha procedurat dhe informacionet/modelet e vlerësimit të aplikuara në nivel institucional siç janë; Vlerësimi i Paanësisë, Transparencës, Krahasueshmërisë dhe Raporti i Auditimit, Raportet e Vlerësimit të kolegëve dhe Raporti i Vlerësimit Individual. Procedura e këtij procesi mbikëqyret nga Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë të institucionit dhe ndiqet nga ZSBC.</p> <p>ZSBC përdor instrumentët të shumëllojshme për mbledhjen, përpunimin dhe shpërndarjen e informacionit mbi cilësinë. UNYT boton raportin vjetor të sigurimit të cilësisë ku trajtohet gjithë problematika e hasur [Dok.21, Quality Assurance Annual Report].</p> <p>Duke qenë së modeli i zgjedhur i programit të studimit BSc në Shkenca Kompjuterike është ai i SUNY-ESC dhe se një pjesë e studentëve ndjekin diplomën e dyfishtë, programi i studimeve BSc. në Shkenca Kompjuterike është në monitorim të vazhdueshëm të cilësisë edhe nga SUNY-ESC dhe punohet mbi bazën e syllabuseve të unifikuara.</p>
---	--

Konkluzionet e vlerësimit:

1. Sistemi i brendshëm i sigurimit të cilësisë është ngritur dhe funksionon me të gjitha strukturat, në përputhje me kërkesat e kërkesat e akteve ligjore dhe nënligjore në Republikën e Shqipërisë;
2. Politikat dhe procedurat për sigurimin e cilësisë janë të shpallura në Statutin, planin Strategjik të UNYT, dhe janë detajuar në Manualin e Sigurimit të Cilësisë të institucionit;
3. Programi i studimeve BSc. në Shkenca Kompjuterike është në monitorim të vazhdueshëm të cilësisë edhe nga SUNY-ESC dhe punohet mbi bazën e kurrikulave dhe syllabuseve të unifikuara.

POLITIKAT E FORMIMIT TË STUDENTËVE

7. Programi i studimit, organizimi i tij

Sipas RVB [Dok.2, faqe 45], programi Bachelor në Shkenca Kompjuterike është projektuar për t'u ofruar studentëve mundësinë për të eksploruar dhe studiuar në fusha të shkencave kompjuterike të njohura ose në zhvillim të shpejtë nëpërmjet një qasjeje akademike dhe profesionale. Si i tillë programi synon një shumëllojshmëri individësh që dëshirojnë të fitojnë njohuri të specializuara si pjesë e edukimit të tyre. Çdo kurs vlerësohet nëpërmjet dy komponentëve kyç, përkatësisht, provimit ndërmjetës dhe përfundimtar me shkrim si dhe detyrave të kursit.

Sipas RVB [Dok.2, faqe 45], programi ka një qasje të fortë krahasuese dhe ndërkombëtare, duke mbuluar nënfusha të gjera në fushën e shkencave kompjuterike që përfshijnë rrjetet, inxhinierinë e softuerit, bazat e të dhënave dhe kurse të tjera si Parime të Menaxhimit që u japin studentëve një perspektivë më të gjera si të shkencës kompjuterike ashtu edhe të menaxhimit.

Qëllimet kryesore të programit mund të përmbliidhen si më poshtë [RVB, faqe 45].

- Krijimi i specialistëve dhe kërkuesve që do të jenë liderë të ardhshëm në departamentet e tyre përkatëse në industri apo akademi.
- Eksplorimi i tendencave aktuale në të cilat industria e TI dhe Shkencave Kompjuterike në tërësi po zhvillohen si dhe pajisjen e studenteve me arsimin e nevojshëm për të zotëruar dhe zhvilluar këto tendenca.
- Plotësimi i boshllëqeve aktuale në industrinë e TI në Shqipëri me specialistë në fushat më të kërkuara, si Rrjetat Kompjuterike, Inxhinieria e Softuerit, Siguria dhe Menaxhimi i Bazave të të dhënave.

Në përfundim të programit të studimit, studentët duhet të kenë zhvilluar aftësitë që i lejojnë ata të:

- Projektojnë zgjidhje konkrete për probleme ku nevojitet përdorimi i sistemeve kompjuterike;
- Zhvillojnë programe kompjuterikë për menaxhimin e skenarëve kompleksë;
- Zhvillojnë baza të dhënash dhe ti manipulojnë dhe mirëmbajnë ato;
- Mësojnë gjuhë të tjera programimi duke u përshtatur me shpejtësi me ndryshimin shumë të shpejtë të teknologjisë;
- Përshtaten me teknologji të reja në fushën e inxhinierisë software, të databazave, të rrjeteve kompjuterike, sistemeve web dhe sistemeve server;
- Mirëmbajnë sisteme informative komplekse dhe t'ju përgjigjen me aftësi të lartë kërkesave të menaxherëve për raporte dhe të dhëna, me synim vendimmarrjen optimale;
- Marrin pjesë në projekte të inxhinierisë software dhe të demonstrojnë aftësi në praktikat e avancuara të zhvillimit të softwarëve;
- Dëshmojnë aftësi ekselente të komunikimit gojor dhe shkrimor dhe të punuarit në grup, si dhe aftësi të adaptimit ndaj situatave të ndryshme;
- Edukohen me mjetet, konceptet dhe metodologjinë e kërkuar për kërkim shkencor të pavarur;
- Përftojnë njohuritë e nevojshme teorike për të mundësuar studimet e mëtejshme të Masterit në Shkenca Kompjuterike.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Viti i fillimit, qëllimet dhe objektivat e çdo programi studimi

Programi i studimit Bachelor në Shkenca Kompjuterike ofrohet që nga viti 2002 nga Universiteti i New York-ut Tiranë. Ky program studimi ofrohet në bashkëpunim me Universitetin Shtetëror të New York-ut, Empire State College, (SUNY-ESC) New York, SHBA).

Organizimi i programit të studimit (vite, semestra, javë etj.)

Programi zhvillohet me një kohëzgjatje prej kater vitesh dhe organizohet si më poshtë:

- Semestri i parë fillon në Tetor të çdo viti dhe përfundon në fund të Shkurtit.
- Semestri i dyte fillon në Mars deri në muajin Qershor.
- Semestri veror zgjat një muaj në Korrik.

Organizimi i programit:

- 1 vit akademik ka 30 javë mësimore në auditor
- 1 Semestër ka 15 javë mësimore në auditor
- 1 ECTS = 25 orë mësimore punë të studentit
- 1 orë mësimore = 60

Plani mësimor sipas viteve akademike, ndarja e ECTS sipas formave të mësimdhënies për çdo lëndë

Tabela 10 në aneks paraqet planin mësimor për të katër vitet akademike. Referuar këtij plani studenti duhet të realizojë në total 256 ECTS të cilat shpërndahen sipas viteve si vijon:

- Viti I : 58 ECTS
- Viti II: 66 ECTS
- Viti III: 62 ECTS
- Viti IV: 70 ECTS

Eventualisht studenti mund të zgjedhë në një semestër më pak lëndë nga ato të programuara, duke grumbulluar kështu më pak kredite [Dok. vizita në institucion]. Kjo mund të çojë në zgjatjen e afatit të realizimit të programit, por i mundëson studentit organizimin e shlyerjes së programit në funksion të mundësive individuale. Në fillim të semestrit studenti bën rregjistrimin e lëndëve, por eventualisht mund të tërhiqet nga një (apo më shumë) lëndë brenda javës së parë të semestrit përkatës të fillimit të zhvillimit të lëndës.

Plani mësimor, megjithë variacionet që ka pësuar në vite kryesisht si pasojë e ndryshimeve në legjislacionin shqiptar, është stabilizuar përfundimisht në versionin me katër vite akademike dhe me 256 ECTS sipas modelit të Universitetit Shtetëror të New York-ut (SUNY-ESC). Kjo lehtëson menaxhimin e programit, duke qenë se ky program studimi mundëson edhe përfitim (për të interesuarit) e një diplome të Universitetit Shtetëror të New York-ut.

Gjithashtu, përmirësimet në planin mësimor ndjekin ato të Universitetit Shtetëror të New York-ut për programin përkatës në Shkenca kompjuterike, duke bërë që ky plan mësimor të ndjekë zhvillimet bashkëkohore në fushën e shkencave kompjuterike. GVJ është i mendimit që ky element përbën një garanci për një plan mësimor që ofron një formim bashkëkohor të të diplomuarve duke u mundësuar atyre jo vetëm punësimin në tregun vendas, por edhe punësimin në tregun rajonal e më gjerë. Gjithashtu kjo bën të mundur vazhdimin lehtësisht të studimeve në ciklin Master si brenda vendit (eventualisht në UNYT), ashtu edhe jashtë vendit.

Tabela 11 në aneks paraqet planin mësimor të ndarë sipas veprimtarive formuese.

Duke ju referuar kësaj tablele në trajtë të përmbledhur kemi elementët në vijim të veprimtarive formuese të ballafaquara me VKM Nr. 41, datë 24.1.2018:

Kategoria	Sipas VKM Nr. 41, datë 24.1.2018		Programi i studimeve Bachelor në Shkenca Kompjuterike
	Tipi i komponentit mësimor	Cikli Bachelor	
A	LËNDË BAZË përgatitje metodologjike dhe kulturë e përgjithshme	15% - 20% (kredite)	18.7%
B	LËNDË KARAKTERIZUESE përgatitje për disiplinën shkencore	50% - 55% (kredite)	45.3%
C	LËNDË NDËRDISIPLINORE/ INTEGRUESE nëndisiplina, profile dhe grup-lëndë me zgjedhje	12% -15% (kredite)	16.4%
D	LËNDË PLOTËSUESE gjuhë të huaja, njohuri informatike, praktika profesionale	10-15% (kredite)	16.4%
E	DETYRIME PËRMBYLLËSE	3%-5% (kredite)	3.2%

Përgjithësisht respektohet shpërndarja e lëndëve sipas kategorive formuese. Eventualisht mund të konsiderohej një rritje e elementëve formues të kategorisë B dhe ulje e lehtë e kategorive C dhe D.

Mënyra e përcaktimit të krediteve (ECTS) për format e studimit:

Sipas RVB dhe takimeve me Përgjegjës të Departamenti dhe pedagogët e lëndëve, kurset zhvillohen në një mënyrë integrale duke mos ndarë në seksione të veçanta leksionet, seminarët ose seancat laboratorike. Të gjithë këto komponentë zhvillohen bashkërisht si pjesë e leksionit për çdo kurs.

- Leksionet 45 orë në auditor dhe 105 orë punë e pavarur e studentit për lëndet të barazvlefshme me 3 kredite amerikane ose 6 ECTS.
- Leksionet 60 orë në auditor dhe 140 orë punë e pavarur e studentit për lëndet të barazvlefshme me 4 kredite amerikane ose 8 ECTS.

Sipas kësaj skeme koha e punës në auditor përbën vetëm 30% të kohës totale të punës për realizimin e një krediti ECTS.

Duke ju referuar VKM Nr. 41, datë 24.1.2018, ndarja e orëve mësimore në auditor në orë për leksione, seminare, lëndë individuale artistike, ushtrime e laboratorë për çdo disiplinë, përcaktohet në planin mësimor të programit të studimit, në bazë të krediteve, që ka secila disiplinë. Në këtë aspekt do të duhej të specifikoheshin në planin mësimor të gjithë këta elementë me qëllim që të mund të gjykohej edhe për raportet eventuale.

Ndryshimet në Planin mësimor, krahasuar me programet mësimore të licensuara

Tabela 12 në aneks paraqet ndryshimet e planit mësimor të vitit akademik 2018-2019 me planin mësimor që i korrespondon akreditimit të vitit 2013. Në total, 8 lëndë janë zëvendësuar me lëndë të reja, me një total prej 48 ECTS nga 256 ECTS për programin në tërësi. Pra ndryshimet në planin mësimor përbëjnë rreth 18.75% të të gjithë programit.

Departamenti i Shkencave Kompjuterike punon në mënyrë të vazhdueshme për përmirësimin e planit mësimor dhe përshtatjen me zhvillimet e shpejta në fushën e shkencave kompjuterike. Ndryshimet e propozuara i nënshtrohen jo vetëm një diskutimi në departament, por i nënshtrohen edhe ekspertizës së SUNY-ESC duke

qenë se si plani mësimor edhe syllabuset e lëndëve duhet të jenë të sinkronizuara me këtë universitet [Dok.34, Vlerësim nga ana e SUNY-ESC i ndryshimeve ne kurrikulumin e BSc ne Shkenca Kompjuterike]. Kjo përbën një garanci për një plan dhe syllabus bashkëkohor.

Planet mësimore të lidhura me personelin akademik përkatës

Tabelat nga 13.1 në 13.6 në aneks pasqyrojnë planin mësimor të lidhur me personelin akademik përkatës për 6 vitet e fundit akademike.

Vihet re se stafi akademik i angazhuar është një staf akademik cilësor, kryesisht me tituj e grada dhe me eksperiencë në fushën e mësimdhënies si dhe me një aktivitet të gjerë shkencor individual.

Vlerësimi për Syllabus-et dhe elementët e tyre, për çdo lëndë.

Syllabuse e lëndëve përmbajnë elementët në vijim:

Pedagogëve përkatës të lëndëve u është kërkuar të njekin një model të syllabuseve, i cili pasqyron elementët bazë si në listën e mëposhtme:

- Emërtimi i lëndës/modulit
- Emri i pedagogut që do të zhvillojë lëndën
- Vendi që zë lënda në formimin tërësor të studentit
- Njohuritë paraprake që duhet të ketë studentit për përvetsimin e lëndës
- Çfarë njohurish dhe aftësish i jep studentit kjo lëndë
- Temat që do të trajtojë lënda në formimin teorik dhe praktik
- Orari dhe vendi i zhvillimit
- Format dhe metodat e mësimdhënies të lëndës
- Format e vlerësimit të studentëve
- Detyrimet e studentit për lëndën
- Literatura e detyruar dhe ajo ndihmëse


Analizë e cilësisë së syllabuseve

Duket se programi i studimit Bachelor në Shkenca Kompjuterike në UNYT është organizuar, autorizuar dhe mbikqyrur nga State University of New York/ESC duke mundësuar edhe përfitim të një diplome të dyfishtë. Ka përpjekje të vazhdueshme për përmirësimin si të kurrikulës ashtu edhe të syllabuseve të lëndëve përkatëse.

Zgjedhja e modelit amerikan dhe bashkëpunimi me State University of New York/ESC, bëjnë që cilësia e kurrikulës të evoluojë pozitivisht dhe në përshtatje me zhvillimet teknologjike botërore.

Nga analiza e syllabuseve nga ana e GVJ, rezulton se ato janë hartuar me objektiva të qarta duke përfshirë në to emrin e pedagogut, të dhëna mbi pedagogun, kohën dhe vendin e zhvillimit, qëllimin, objektivat, temat që do të zhvillohen, literaturën e nevojshme bazë dhe atë plotësuese, faqen web të lëndës, detyrimet e lëndës me përshkrimin e tyre, mënyrën e vlerësimit dhe kërkesat specifike të lëndës. Eventualisht në syllabus mund të specifikoheshin të ndara në kredite aktivitetet formuese përbërëse të lëndës përkatëse.

Vlerësimi sipas Standardeve



Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
I - PROGRAMET E STUDIMEVE TË OFRUARA	
Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ofron programe të akredituara të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS);</p> <p>Kriteri 2 Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek një program studimi me kohë të plotë është 60 kredite;</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në Shkenca Kompjuterike është akredituar me Urdhër të Ministrit të Arsimit, Nr.384, datë 6.9.2013, për një periudhë 6 vjeçare. Ky program, me kohëzgjatje 4 vjet, përfundon me diplomën Bachelor dhe ofrohet i organizuar në module dhe i vlerësuar në kredite, sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p> <p>Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti akademik nga një student që ndjek këtë program studimi me kohë të plotë është 64 kredite ECTS (me variacione të vogla sipas viteve). Për të katër vitet e studimit, studenti duhet të grumbullojë 256 kredite ECTS që të diplomohet.</p>
II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE	
Standardi II.4 - Programet e studimeve të ciklit të parë janë të detajuara dhe informuese.	
<p>Kriteri 1 Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për përmbajtjen e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për lëndët me zgjedhje apo të detyruara për semestër;</p> <p>Kriteri 3 Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor, frekuentimin/ ndjekjen e programit;</p> <p>Kriteri 4 Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për sillabuset e detajuara për secilën lëndë, për praktikat, ushtrimet apo orët e laboratorit, etj.</p>	<p>Departamenti pajis studentët me të gjithë sillabuset e lëndëve, ku jepen në detaje temat e lëndës, literatura kryesore, format e kontrollit të dijeve dhe literatura e rekomanduar. Për këtë organizohet dita e orientimit ku informohen studentët në lidhje me aspektet e programit të studimit si informacione të tjera mbi jetën studentore.</p> <p>Informacioni në lidhje me programet e studimit, mund të gjendet edhe në faqen e internetit të institucionit:</p> <p>http://unyt.edu.al/index.php/bachelor-programs/computer-science/</p> <p>Informacioni i shkruar për këtë qëllim mund të përftohet edhe në Manualin e Studentit (STUDENT HANDBOOK) [Dok.11, Student Handbook 2018], i cili, pasqyron gjithë elementët që lidhen me programet e studimit, përfshirë planin mësimor, kriteret e përgjithshme të vlerësimit, sistemin e notave, etj.</p>
Konkluzionet e vlerësimit:	
<ol style="list-style-type: none"> 1. Programi i studimit BSc në “Shkenca Kompjuterike”, me kohëzgjatje 4 vjet, është i organizuar në module me vlerësim në kredite sipas sistemit amerikan (por të ekuivalentuar në 256 kredite në sistemin ECTS), duke ofruar një përgatitje bashkëkohore e duke mundësuar zgjerimin e njohurive të kandidatëve në drejtime specifike të domosdoshme për karrierën e tyre; 2. Ky program është hartuar në përputhje me misionin dhe strategjinë e UNYT për zhvillim duke ju përshtatur kërkesave të tregut të punës për specialistë të kualifikuar në këto fusha; 3. Mësimdhënia zhvillohet në gjuhën angleze duke përgatitur në këtë mënyrë specialistë të aftë për tregun ndërkombëtar të punësimit; 4. Realizimi i programit mbështetet nga një staf akademik i motivuar dhe me nivel të lartë shkencor; 5. Studentët disponojnë gjithë informacionin për programin e studimit. Politikat e formimit të studentëve janë bashkëkohore, transparente dhe të mirëstudiuara në rang ndërkombëtar; 	

6. Programi i studimit është i hartuar në bashkëpunim me një universitet prestigjioz amerikan, SUNY/ESC, në bashkëpunim me të cilin janë hartuar dhe pasuruar kurrikulat;
7. Studentët e programit BSc në “Shkenca Kompjuterike” kanë mundësinë të përftojnë një diplomë të dyfishtë me SUNY/ESC duke rritur mundësitë e tyre për punësim edhe në tregun rajonal e më gjerë.

8. Mësimdhënia

Organizimi i mësimdhënies në UNYT bazohet dhe përmbush kërkesat e legjislacionit në fuqi, mbështetet njëkohësisht edhe në eksperiencat më të mira, kryesisht ato ndërkombëtare [Dok. vizita në institucion]. Bazuar në rolin që çdo disiplinë mësimore ose veprimtari formuese luan në formimin e studentit, programet e studimit organizohen në 6 kategori disiplinash:

- Kategoria A: Veprimtari në disiplina të formimit të përgjithshëm
- Kategoria B: Veprimtari në disiplina karakterizuese të programit të studimit
- Kategoria C: Veprimtari në disiplina të ngjajshme dhe/ose integruese, që lidhen me disiplinat karakterizuese.
- Kategoria D: Disiplina me zgjedhje të studentit, ndër disiplinat e ofruara nga institucioni;
- Kategoria E: Njohuri të tjera formuese, si plotësime në gjuhë të huaja, informatikë, prezantuese, stazh apo praktikë, etj.
- Kategoria F: Teza e diplomës.

Për secilën lëndë, në syllabusin përkatës, jepen detaje për elementët përbërës dhe mënyrën e shlyerjes së lëndës.

Mësimdhënia realizohet në trajtën e leksioneve, seancave laboratorike, seminareve, projekteve dhe punës së pavarur të studentit. Teknologjia e përdorur në mësimdhënie është bashkëkohore dhe e përshtatur me lëndët përkatëse.

Për studentët e që aspirojnë për një diplomë të dyfishtë organizohen edhe leksione online me staf akademik të SUNY-ESC [Dok. vizita në institucion].

Kontrolli i njohurive realizohet duke marra në konsideratë gjithë elementët formues dhe përgjithësisht janë të pranishme 2 provime: ai ndërmjetës dhe ai final. Elementë të tjerë si detyra kursi, case study, detyra etj. merren në konsideratë me një përqindje të caktuar një parashikohet specifikisht në syllabuset e lëndëve. Për përvetësimin e lëndës studentët kanë në dispozicion literaturën bazë e cila është e disponueshme në bibliotekë. Realizimi i projekteve mund të jetë individual ose edhe në grup dhe vlerësimi përgjithësisht paraprihet nga prezantime të studentëve pjesëmarrës.

Shkëmbimi i informacionit me studentët lidhur me lëndët përkatëse realizohet nëpërmjet faqeve web të dedikuara. Çdo lëndë ka një website ku pedagogu jo vetëm transmeton materialet e nevojshme për përvetësimin e lëndës, por pasqyron edhe rezultatet e provimeve apo edhe të vlerësimeve të tjera të kryera.

Çështje të kontrollit të njohurive, si provimet, riprovimet, përmirësimi i notës, kriteret e mbartjes dhe ecurisë akademike, etj. trajtohen në Rregulloren e programit [Dok Rregullore e Programit Bachelor].

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Llojet e Formave të mësimdhënies, për lëndët/modulet:

Plani mësimor nuk parashikon ndarjen e orëve në auditor në format përbërëse të mësimdhënies. Edhe syllabuset e lëndëve nuk parashikojnë një ndarje të tillë, por i lihet pedagogut përkatës organizimi i lëndës sipas formave të mësimdhënies.

Në tabelën 14 në aneks pasqyrohen vetëm orët totale në auditor.

Format e kontrollit të njohurive

Kontrulli i njohurive përgjithësisht organizohet në trajtën e dy provimeve, ai ndërmjetës dhe ai final dhe sipas lëndëve integrohen edhe elementë të tjerë si detyrat, projektet etj.

Një variant tipik i formave të kontrollit të njohurive jepet në tabelën 15 në aneks.

Aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj

Aktiviteti i studentëve në komponentët e aktivitetit të Departamentit jepet në tabelën 16 në aneks. Konstatohet që ky aktivitet është relativisht i kufizuar dhe nën kapacitetin që mund të ofronte cilësia e studentëve dhe e stafit akademik.

Nga vizitat në institucion dhe takimet si me studentët ashtu edhe me stafin akademik, GVJ konstaton se cilësia e mësimdhënies mbetet preokupim i vazhdueshëm i stafit drejtues dhe atij mësimdhënës dhe ajo sigurohet si nga përzgjedhja rigoroze e stafit akademik ashtu edhe nga vlerësimet periodike të kryerasi nga studentët ashtu edhe nga kolegët. Një rëndësi e veçantë i është kushtuar kontrollit të përvetësimit të dijeve, që studentët marrin në lëndë të ndryshme. Mënyrat e përdorura janë funksionale, e venë studentin në pozita pune e ndërkohë janë mjaft transparente.

9. Studentët

Referur RVB dhe rregullores së Zyrës së Pranimeve rezulton se pranimi i studentëve në programin e studimeve Bachelor në Shkenca Kompjuterike kryhet bazuar në procedura të qarta pranimi bazuar në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi si dhe në aktet e brendshme të UNYT.

Studentët e pranuar në këtë program studimi duhet të plotësojnë minimalisht kushtet në vijim [Dok.63, Kriteret e pranimit]:

- Notë mesatare të shkollës së mesme mbi 6.5;
- Niveli i gjuhës angleze B1.

Dokumentacioni i kërkuar për rregjistrim është si vijon:

1. Formulari i Aplikimit;
2. Fotokopjen e noterizuar të diplomës së Maturës Shtetërore ose të dëftesës së pjekurisë, së bashku me certifikatën e notave ose të një dëftese/diplome tjetër studimi të fituar jashtë vendit dhe të njësuar në MASR;
3. 4 (katër) fotografi me përmasat e pasaportës;
4. Deklaratën e paraqitur në shtojcën, bashkëlidhur udhëzmit përkatës të atij viti akademik (i nënshkruar nga aplikanti dhe nga punonjësja e sekretarisë).

Numri total i studentëve të rregjistruar në 6 vitet e fundit është 199, nga të cilët 33 studentë të transferuar.

Pas rregjistrimit dhe transmetimit të informacionit dhe dokumentacionit nga Zyra e Pranimeve, Sekretaria mësimore mban gjithë informacionin në lidhje me progresin e studentit gjatë viteve të studimeve e deri në diplomimin e tij [Dok. vizita në institucion].

Vlerësimi i Tregues të matshëm:

Procedurat e pranimit të studentëve

UNYT ka në strukturën e vet Zyrën e Pranimeve ("Admissions Office"), e cila sigurohet për ndjekjen e procedurave të duhura për pranimin dhe regjistrimin e studentëve të rinj. Procedurat aktuale të pranimit të studentëve të rinj në programet bachelor janë të përshkruara në rregulloren e Zyrës së Pranimeve, pika 4 [Aneksi 18.1: Admissions Office Rules & Regulations]. Ato përmblihen me hapat e mëposhtëm:

- Para-aplikimet për regjistrim në programet e ciklit të parë të studimeve në UNYT janë të mundura në çdo kohë të vitit akademik.
- Aplikantët mund të aplikojnë nëpërmjet web-it, e-mail-it, telefonit ose duke vizituar ambientet e UNYT ose/edhe sipas përcaktimeve në ligjet përkatëse.
- Zyra e pranimeve (ZP) kontrollon kualifikueshmërinë e aplikantit bazuar në kriteret e pranimit të përcaktuara me vendimin përkatës të Rektoratit.
- Zyra e pranimeve (ZP) njofton aplikantin duke përdorur informacionin e tij / saj të kontaktit për para-pranimin; dhe nëse aplikanti është pranuar për regjistrim i bëhet e ditur lista e dokumenteve të nevojshme të regjistrimit.
- Nëse kandidati nuk posedon një rezultat të suksesshëm në asnjë prej Certifikatave të njohura të Gjuhës Angleze atëherë kandidati i nënshtrohet testit Apts, që organizohet nga Zyra e pranimeve (ZP) në bashkëpunim me British Council.
- Zyra e pranimeve (ZP) kontrollon listën e dokumenteve të dorëzuara nga kandidati për vlefshmërinë.
- Zyra e pranimeve (ZP) dërgon dosjen e kompletuar në Komisionin e Pranimit për miratim dhe pastaj dosjet transferohen në Zyrën e Regjistrimit

Studentë të regjistruar në vitin e Parë (për herë të parë). Cilësia në hyrje.

Numri i studentëve të regjistruar në vitin e parë jepet në Tabelën 17 dhe për katër vitet e fundit është 158 studentë. Për studentët e regjistruar në 6 vitet e fundit rezulton një notë mesatare në hyrje sipas viteve që varion nga 8.1 në 9. Kjo dëshmon për një kontigjent shumë cilësor që kërkon të ndjekë studimet në këtë program, duke kontribuar në këtë mënyrë edhe për një nivel cilësor të formimit në fushën e shkencave kompjuterike.

Mobiliteti i studentëve brenda sistemit të arsimit të lartë në vend

Nuk ka patur studentë të cilët kanë realizuar mobilitete brenda sistemit të arsimit të lartë në vend.

Të dhëna për punësimin e studentëve

UNYT disponon të dhëna për punësimin e studentëve të diplomuar për të 6 vitet e fundit.

Numri total të diplomuarve. Numri total i të punësuarve (në përputhje me diplomën)

Për 6 vitet e fundit janë diplomuar 46 studentë.

Të gjithë studentët e diplomuar në 6 vitet e fundit janë punësuar në përputhje me diplomën. Kjo dëshmon për cilësinë e përgatitjes së të diplomuarve në këtë program studimi.

Bazuar në RVB, në gjëndjen e konstatuar gjatë vizitës në UNYT dhe dokumentacionin shtesë të marrë gjatë vizitës në institucion rezulton se procedura e pranimit të studentëve zhvillohet në përputhje me legjislacionin dhe rregulloret në fuqi dhe se mbahen informacione të detajuara jo vetëm në raport me evolucionin e studentit

në programin e studimit, por edhe në raport me punësimin. Nuk u evidentuan ndryshime ndërmjet të dhënave të deklaruara dhe atyre të konstatuara.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
IV - INSTITUCIONI MBRON TË DREJTAT E STUDENTËVE	
Standardi IV.1 - Institucioni ndjek një politikë të mirëprirjes së studentëve të rinj.	
<p>Kriteri 1 Pranimi në ciklin e parë të studimeve bëhet në përputhje me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe aktet nënligjore në fuqi.</p> <p>Kriteri 2 Institucioni i Arsimit të Lartë propozon kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, të cilët kanë mbaruar Maturën Shtetërore, për t'u pranuar në ciklin e parë të studimeve.</p>	<p>Për periudhën e marrë në analizë (6 vitet e fundit) pranimi i studentëve në programin e studimit Bachelor në Shkenca kompjuterike është bërë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.</p> <p>Për këtë program studimi UNYT ka vendosur kriteret shtesë [Dok.63, Kriteret e pranimit] si:</p> <ul style="list-style-type: none"> - notë mesatare të shkollës së mesme mbi 6.5; - Niveli i gjuhës angleze B1.
Standardi IV.2 - Institucioni informon studentët në lidhje me politikat e punësimin.	
<p>Kriteri 1 Studentët informohen në mënyrë të detajuar për programin e studimit, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Studentët vlerësojnë pedagogun e çdo lende, në përfundim të semestrit;</p> <p>Kriteri 3 Studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës;</p> <p>Kriteri 4 Studentët informohen mbi mundësitë për punësim pas diplomimit në këtë program studimi.</p>	<p>Studentët informohen në rrugë të ndryshme në lidhje me programin e studimit (përfshirë planin mësimor, kriteret e përgjithshme të vlerësimin, sistemin e notave, etj.) nëpërmjet:</p> <ul style="list-style-type: none"> - faqes së internetit http://unyt.edu.al/index.php/bachelor-programs/computer-science/ - Manualit të Studentit (STUDENT HANDBOOK); - Ditës së orientimit; - Koordinatorit të programit. <p>Vlerësimi i pedagogëve të lëndëve kryhet nëpërmjet 2 anketimeve në vit me studentët për secilën lëndë që ofrohet çdo semester dhe nga një anketim për çdo lëndë që ofrohet vetëm një herë në vit [Dok.39, Course Evaluation Form from Students].</p> <p>UNYT ka në strukturën e vet Zyrën e Karrierës dhe të marrëdhënieve me të diplomuarit [Dok.18, Organizational Chart], e cila ofron një sërë shërbimesh në ndihmë të punësimin të studentëve dhe mbajtjen e kontakteve me ta pas punësimin.</p>
Standardi IV.3 - Institucioni disponon statistika në lidhje me numrin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të parë.	
<p>Kriteri 1 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e të diplomuarve, në ciklin e parë;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve;</p> <p>Kriteri 3 Institucion disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi, deri në diplomim.</p>	<p>UNYT përdor sistemin informativ E-GNOMON për mbajtjen e të dhënave [Dok. 65] që kanë të bëjnë me progresin akademik të studentëve deri në diplomimin e tyre. Notat hidhen në këtë bazë të dhënash dhe mund të aksesohen nga studentët në mënyrë elektronike.</p> <p>Informacioni lidhur me studentët e regjistruar, tërheqjet nga programi, studentët e transferuar, si dhe studentët e diplomuar menaxhohen nga Sekretaria Mësimore [Dok. vizita në</p>

	<p>institucion].</p> <p>Nga verifikime e GVJ në Sekretarinë Mësimore rezultoi një informacion i mbajtur në mënyrë korrekte dhe në përputhje me aktet ligjore e nënligjore si dhe aktet e brendshme të UNUT [Dok. vizita në institucion].</p>
<p>Standardi IV.4 Institucioni angazhon personelin e tij për përkujdesjen ndaj studentëve.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni u ofron këshillim karriere studentëve, ndjek progresin e tyre dhe i ndihmon ata në çështjet që kanë të bëjnë me procesin mësimor;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni (nëpërmjet zyrës për këshillimin e karrierës) ndihmon studentët në përzgjedhjen e institucionit në të cilin ata do të zhvillojnë praktiken profesionale, në rastet kur parashikohet një e tillë.</p>	<p>UNYT mbështet studentët në gjithë fazat që lidhen me aktivitetin pranë këtij institucioni. Që në fazën e pranimit e në vijim studentit i caktohet një këshillues akademik (academic advisor) me detyra të përcaktuara qartë për orientimin e studentit. Këshilluesi akademik ndjek nga afër progresin e studentit duke e udhëzuar atë në procesin e zgjedhjes dhe rregjistrimit të lëndëve çdo semestër e për çdo problematikë tjetër korrente lidhur me procesin mësimor.</p> <p>Pranë UNYT funksionon Zyrën e Karrierës dhe të marrëdhënieve me të diplomuarit e cila i ndihmon studentët për aspekte të ndryshme të zhvillimit të karrierës si përgatitje CV, përgatitje për intervista, gjetje internship, kontakte me biznesin etj.)</p>
<p><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. UNYT ka procedura të mirëpërcaktuara pranimit bazuar në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi si dhe në aktet e brendshme të tij; 2. UNYT ka vendosur edhe kritere suplementare pranimit për këtë program studimi si notë mesatare të shkollës së mesme mbi 6.5 dhe nivel të B1 të gjuhës angleze; 3. Studentët informohen në rrugë të ndryshme në lidhje me programin e studimit; 4. UNYT ka një sistem informacioni që menaxhohet nga Sekretaria Mësimore ku ruhen rekorde të plota të gjithë progresit të studentit gjatë fazës së studimeve dhe të diplomimit; 5. Pranë UNYT funksionon Zyrën e Karrierës dhe të marrëdhënieve me të diplomuarit e cila i ndihmon studentët për aspekte të ndryshme të zhvillimit të karrierës. 	

KËRKIMI SHKENCOR NË FUNKSION TË PROGRAMIT TË STUDIMIT.

10. Kërkimi shkencor

Dokumentet bazë në të cilët bazohet organizimi dhe zhvillimi i kërkimit shkencor në UNYT është Plani Strategjik i UNYT 2018-2022 [Dok.13, Plani Strategjik 2018-2022] dhe Drejtimet Kryesore të Kërkimit Shkencor 2018-2022 [Dok.71, Drejtimet Kryesore të Kërkimit Shkencor 2018-2022].

Në planin Strategjik të UNYT 2018-2022 përcaktohet si objektiv strategjik Nr.1 “Zgjerimi dhe mbështetja e Programit Kërkimor të UNYT”. Në zbatim të këtij objekti strategjik janë përcaktuar nënobjektivat për secilin Fakultet dhe rrugët për realizimin e tyre si [Dok.13, Plani Strategjik 2018-2022]:

- I- Puna kërkimore e Fakultetit të Informatikë duhet të mbështetet në shtyllat në vijim:
 - a. Shkenca, Teknologjia dhe Komuniteti;

- b. Inxhineria e Softuerit dhe Sistemet e Informacionit;
 - c. Teoria e Kompjutacionit.
- 2- Zbatimi në UNYT i një politike promovimi akademik dhe i sistemit përkatës të matjes të cilësisë / sasisë së produktit kërkimor (miratuar nga Senati më 30 mars 2018) për të inkurajuar publikime nga çdo fakultet, në tekstesh, ose botime në revista të njohura;
 - 3- Të tre fakultetet e UNYT, së bashku, individualisht ose në bashkëpunim me institucione të tjerë të arsimit të lartë të organizojnë një konferencë secili përgjatë 5 viteve të ardhshëm. Në këtë proces duhet të kenë një rol të veçantë Qendrat Kërkimore. Materialet e konferencave do të botohen në volume të veçantë;
 - 4- UNYT duhet të rrisë mbështetjen financiare për një numër më të madh të anëtarëve të stafit akademik të cilët shprehin interesin për pjesëmarrje në konferenca shkencore ndërkombëtare;
 - 5- Mbështetja e Zyrës së Projekteve me staf në rolin e koordinatorit të projekteve dhe të asistentit kërkimor. Zyra Juhet të mbështesë stafin akademik në formulimin e projekteve si dhe në koordinimin e aktiviteteve në kuadër të tyre;
 - 6- Të garantohet publikimi i revistës Outlook Global;
 - 7- Themeli i një UNYT Press duhet të vijë në rendin e ditës dhe të mos vonohet më tej.

Në se analizohet aktiviteti kërkimor në shërbim të programit të studimit Bachelor në Shkenca Kompjuterike, në masën më të madhe ai mund të konsiderohet i lidhur me aktivitetin e Departamentit të Shkencave Kompjuterike dhe, duke filluar nga viti 2017 edhe me Qendrën për Kërkime të Avancuara Kompjuterike.

Ky aktivitet kërkimor bazohet në drejtimet kërkimore të përcaktuara për periudha përgjithësisht 5 vjeçare. Mund të përmendim këtu dokumentin që i korresponon periudhës 2013-2018 [Research Pillars 2013-2018] dhe dokumentin vijues që i korresponon periudhës 2018-2022 [Main Research Pillars 2018-2022]. Në dokumentin që i korresponon periudhës 2013-2018 si dhe në dokumentin që pasqyron aktivitetin kërkimor për periudhën 2012-2018 [Dok.80 Research Output 2012-2018] jepet aktiviteti kërkimor i realizuar gjatë kësaj periudhe në trajtën e projekteve dhe botimeve në të cilin është angazhuar stafi akademik dhe eventualisht studentët. Dokumenti [List of Projects & Research Partners] paraqet listën e projekteve në të cilat ka qenë pjesëmarrës UNYT për periudhën duke filluar nga viti 2011 e në vazhdim. Kjo tregon për një angazhim të institucionit për të marrë pjesë në projekte të financuara në rang rajonal e Europian.

Një rol të veçantë në nxitjen e kërkimit shkencor dhe koordinimin e tij në rang Fakulteti pritet të luajë Qendra për Kërkime të Avancuara Kompjuterike. Megjithatë, duke ju referuar raportit vjetor të monitorimit për vitin akademik 2017-2018, duhet thënë se megjithëse ka pothuajse dy vjet që është ngritur aktiviteti dhe roli i saj le akoma për të dëshiruar [Dok.Shtesë 2, Annual Monitoring Report].

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Të dhëna për kërkimin shkencor

Tabela 19 në ankes paraqet aktivitetin kërkimor në trajtën e botimeve (61 tekste, 117 artikuj në revista shkencore, 207 pjesëmarrje në konferenca me proceedings), projekteve kërkimore të fituara (23), projekteve të zbatuara (4), aktivitetet shkencore të organizuara nga institucioni (5 konferenca plus 18 konferenca masteri dhe doktorature), pjesëmarrjen në aktivitete shkencore brenda IAL (>300), numrin e aktiviteteve kërkimore në shërbim të procesit mësimor (5) dhe numrin e studentëve të përfshirë në kërkim (5).

Vihet re një aktivitet i gjerë kërkimor, por që në fakt pasqyron gjithë aktivitetin kërkimor të institucionit dhe jo atë të lidhur specifikisht me programin e studimit. Gjitashtu, numri i studentëve të angazhuar është i vogël.

Në konkluzion GVJ është i mendimit se:

- Personeli akademik i UNYT mban një axhendë dhe outpute aktive kërkimore-shkencore.
- Në planin Strategjik të UNYT 2018-2022 përcaktohet si objektivi strategjik Nr.1 “Zgjerimi dhe mbështetja e Programit Kërkimor të UNYT”
- Botimet e realizuara nga stafi akademik i Departamentit të Shkencave Kompjuterike për periudhën 2013-2018 tregojnë për një orientim të dukshëm në drejtim të kërkimit;
- Rekomandohet fuqizimi i rolit të Qendrës për Kërkime të Avancuara Kompjuterike;
- Rekomandohet rritja e numrit të studentëve të angazhuar në veprimtari kërkimore.

11. Bashkëpunimi kombëtar, ndërkombëtar dhe marrëdhëniet me publikun

Referuar RVB [Dok. RVB, faqe 73] UNYT po ndjek një strategji të ndërkombëtarizimit të bashkëpunimit dhe partneriteteve në një nivel kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar sipas niveleve të mëposhtme të internacionalizimit:

- Ndërkombëtarizimi i kontigjentit studentor [Plani Strategjik 2018-2022, Objektivi Strategjik 4.1].
- Ndërkombëtarizimi i anëtarëve fakultetit [Plani Strategjik 2018-2022, Objektivi Strategjik 4.2].
- Krijimi dhe mbajtja e një rrjeti të partneriteteve ndërkombëtare [Plani Strategjik 2018-2022, Objektivi Strategjik 6], shtrirë edhe në disiplina kërkimore dhe zhvillimore.
- Zhvillimi i programeve të shkëmbimit për studentët, personelin akademik dhe kërkuesit shkencorë [Plani Strategjik 2018-2022, Objektivi Strategjik 4.3].
- Politika e ndërkombëtarizimit [Dok. Strategjia e Ndërkombëtarizimit 2016-2021].

Nga ana tjetër bashkëpunimi i ngushtë me SUNY-ESC shpalos aspektin e bashkëpunimit ndërkombëtar të UNYT. Ky bashkëpunim konkretizohet me ofrimin e diplomës së dyfishtë Bachelor në Shkencën e Kompjuterike.

Bashkëpunimi kombëtar, ndërkombëtar dhe marrëdhëniet me publikun në UNYT menaxhohen nga Zyra e Marrëdhënieve Ndërkombëtare dhe Zyra e Koordinimit me ESC [Dok. Organigrama e UNYT].

GVJ gjatë vizitës në Zyrën e Koordinimit me ESC u njoh me aktivitetin e kësaj zyre që drejtohej nga Koordinatorja e ESC. Aktiviteti kryesor konsistonte në menaxhimin e diplomës së dyfishtë me ESC duke mundësuar rregjistrimin e studentëve për këtë diplomë (pas përfundimit të 60 krediteve amerikane dhe rezultateve të larta) si dhe ndjekjen e tyre deri në diplomim. Gjithashtu kjo zyrë mundëson koordinimin edhe me zyra homologe të tjera si në Pragë, Athinë e Selanik [Dok. vizita në institucion].

Një rol në zhvillimin e bashkëpunimit në nivel kombëtar dhe marrëdhëniet me publikun luan Zyra e Karrierës dhe e Marrëdhënieve me të diplomuarit [Dok. Organigrama e UNYT]. Kjo zyrë inicion dhe mundëson realizimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit të institucionit në nivel kombëtar dhe shërben si urë lidhëse ndërmjet bizneseve dhe vetë institucionit.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Të dhëna për bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar

Të dhënat për bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar pasqyrohen në mënyrë të detajuar në tabelat 20 dhe 21 në aneks. GVJ konstaton se ka një bashkëpunim të gjerë kombëtar e ndërkombëtar që ndihmon në realizimin cilësor të studimit dhe rritjen e vizibilitetit të tij.

- Komunikimi dhe bashkëpunimi me institucionet e tjera shtetërore, organizata profesionale, komunitetin e biznesit, tregun e punës dhe aktorë të tjerë shoqërorë të rëndësishëm për arsimin e lartë.

Rezultojnë 17 marrëdhënie bashkëpunimi në trajtën e memorandumëve të bashkëpunimit dhe pjesëmarrjes në panairë punësimi apo ofrime internshipi gjë që tregon për një qasje të institucionit për një afrim dhe komunikim aktiv me tregun e punës.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përbushja e standardeve
<p>VII - INSTITUCIONI GARANTON MARRËDHËNIE BASHKËPUNIMI, TË BRENDSHME DHE TË JASHTME</p> <p>Standardi VII.1 - Institucioni garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi mes personelit të vet.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni, për hartimin dhe mbikëqyrjen e programit, nxit bashkëpunimin ndërmjet personelit brenda institucionit nëpërmjet shkëmbimit të informacionit;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni, nëpërmjet ndarjes së detyrave mes personelit brenda institucionit, marrjes së përgjegjësisë respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre, garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi.</p>	<p>Nga diskutimet gjatë vizitës në institucion në takimet me stafin akademik dhe drejtuesit e Fakultetit dhe njësisive bazë [Dok. vizita në institucion] GVJ konkludon se ka një bashkëpunim të mirë dhe një shëmbim informacioni dhe eksperiencash ndërmjet personelit akademik. Një kontribut të veçantë në këtë shkëmbim luan edhe vlerësimi i punës së stafit akademik jo vetëm nga studentët, por edhe nga kolegët.</p> <p>Departamenti i Shkencave Kompjuterike materializon shkëmbimin e informacionit nëpërmjet diskutimeve në takime të Departamentit dhe nëpërmjet vlerësimit të performancës së secilit pedagog [Raporti vjetor i monitorimit].</p> <p>Dëshmi e frymës së bashkëpunimit është dhe zhvillimi i aktivitetit kërkimor në ekipe kërkimi dhe botime e realizuara me më shumë se një autor [Research Output 2012-2018].</p>
<p>Standardi VII.2 - Institucioni garanton marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni për realizimin e objektivave të programeve të studimeve dëshmon se ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të programeve të studimeve që ofrojnë;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni organizon trajnime profesionale të mëtejshme në bashkëpunim me punëdhënësit;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni bën një raport analitik të përfitimeve nga marrëveshjet kontraktuale në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në Shkenca Kompjuterike zhvillohet në bashkëpunim me me Universitetin Shtetëror të New York-ut, Empire State College. Ky bashkëpunim bën të mundur që të përftohet një formim bashkëkohor dhe një vizibilitet ndërkombëtar i diplomës.</p> <p>Plus sa më sipër, UNYT ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me shumë institucione të tjera jashtë vendit në mënyrë që të rrisë ndërkombëtarizimin e programeve të studimit dhe mundësuar shkëmbime të studentëve dhe personelit akademik [Memorandumet e bashkëpunimit me universitete e institute].</p> <p>UNYT zhvillon një bashkëpunim të gjerë me një numër të madh institucionesh publike, organizata profesionale, komunitetin e biznesit, etj. Kjo kontribuon jo vetëm në realizimin e suksesshëm të praktikave të ndryshme, por edhe për kontakte me tregun e punës me qëllim punësimin e studentëve të diplomuar.</p>
<p>Konkluzionet e vlerësimit:</p> <p>1- UNYT bashkëpunon me Universitetin Shtetëror të New York-ut, Empire State College duke</p>	

- mundësuar një diplomë të dyfishtë Bachelor në Shkenca Kompjuterike;
- 2- UNYT po ndjek një strategji të ndërkombëtarizimit të bashkëpunimit dhe partneriteteve në një nivel kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar;
 - 3- Bashkëpunimi nivel kombëtar dhe ndërkombëtar është në shërbim të programit të studimit.

ANALIZË PËRMBLEDHËSE PËR PLOTËSIMIN E REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI PARAARDHËS

- | | |
|----------------|-----------------|
| Rekomandimi a) | është plotësuar |
| Rekomandimi b) | është plotësuar |
| Rekomandimi c) | është plotësuar |

ANALIZA PËRMBLEDHËSE E RVJ SIPAS METODËS SWOT (STRENGTHS - PIKAT E FORTA, WEAKNESSES - PIKAT E DOBËTA, OPPORTUNITIES - MUNDËSITË, THREATS - PENGESAT).

a. Pika të forta:

- 1) Bashkëpunimi me me Universitetin Shtetëror të New York-ut, Empire State College, SHBA duke mundësuar përftimin e një diplome të dyfishtë;
- 1) Mësimdhënia në gjuhën angleze;
- 2) Vlerësimi i rregullt i performancës së stafit akademik nga studentët dhe nga kolegët;
- 3) Cilësia e lartë e kurrikulës së ofruar për programin e studimeve bazuar në modelin amerikan;
- 4) Përdorimi i teknologjisë moderne (projektorë, PC, etj.) në procesin e mësimdhënies;
- 5) Bibliotekë që disponon një literaturë të gjerë bazë dhe ndihmëse në shërbim të programit të studimit e me akses të gjerë në biblioteka të ndryshme elektronike;
- 6) Personeli akademik me kualifikimin e duhur për të zhvilluar një proces mësimor cilësor dhe në përputhje me standartet;
- 7) Menaxhimi efektiv i bazës laboratorike nga Zyra e TI duke garantuar funksionimin e paisjeve kompjuterike dhe të softuerëve përkatës në shërbim të procesit mësimor dhe kërkimit.

b. Pika të dobëta:

- 1) Ndryshimet e herë pas herëshme në kohëzgjatjen e studimeve të programit Bsc në Shkenca Kompjuterike (diktuar nga nevoja për t'ju përshtatur ndryshimeve në aktet ligjore dhe nënligjore të arsimit të lartë në vend);
- 2) Ngarkesë mësimore relativisht e lartë për një pjesë të personelit akademik efektiv, duke vështirësuar angazhimin efikas në kërkimin shkencor;
- 3) Mungesa e një studimi tregu të përditësuar në përputhje me Strategjinë e studimit të tregut të UNYT;
- 4) Fonde relativisht të kufizuara për kërkimin shkencor në shërbim të programit të studimit;

5) Numër relativisht i ulët i studentëve të aktivizuar në kërkimin shkencor.

c. Mundësitë:

- 1) Rritja e rekrutimit të studentëve të huaj;
- 2) Përmirësimi i imazhit të Universitetit me orientim më të theksuar drejt kërkimit.
- 3) Rritja e nivelit të pjesëmarrjes në projekte europiane;
- 4) Rritja e kërkesës për të diplomuar cilësorë në fushën e shkencave kompjuterike;
- 5) Rritja e shkallës së mobilitetit të studentëve në kuadër të Programit European Erasmus+;
- 6) Ofrimi i shërbimeve për të tretët;
- 7) Diversifikimi i burimeve të financimit;
- 8) Rritja e bashkëpunimit me universitete brenda vendit dhe ato rajonale.

d. Pengesat:

- 1) Niveli jo i mirë i gjuhës angleze në shkollat e mesme, që bën që shumë studentë të mos zgjedhin për të vazhduar studimet pranë UNYT;
- 2) Ndryshimi i vazhdueshëm i kuadrit ligjor dhe nënligjor të arsimit të lartë në Shqipëri;
- 3) Tarifë relativisht e lartë e shkollimit;
- 4) Vështirësitë për sigurimin e personelit akademik efektiv me kualifikimin e kërkuar.

Rekomandime

- 1) *Rekomandohet realizimi i një studimi të detajuar tregu në përputhje me Strategjinë e studimit të tregut të UNYT;*
- 2) *Rekomandohet që Qendra për Kërkime të Avancuara Kompjuterike, e cila është në hapat e para të konsolidimit të saj, të luajë një rol më të madh në zgjerimin e aktiviteti shkencor të Fakultetit dhe vënien në shërbim të programeve të ofruara të studimeve.*
- 3) *Ngarkesa mësimore e personelit akademik efektiv është përgjithësisht në një interval të pranueshëm, por do të rekomandonim reduktimin e saj për të mundësuar rritjen e angazhimit në kërkim shkencor.*
- 4) *Rekomandohet rritja e numrit të studentëve të angazhuar në veprimtari kërkimore.*

I. SUMMARY ANALYSIS FOR COMPLETION OF RECOMMENDATIONS FROM THE FIRST ACCREDITATION

For recommendation a), **the recommendation is met.**

For recommendation b), **the recommendation is met.**

For recommendation c), **the recommendation is met.**

SUMMARY ANALYSIS FOR THE IMPLEMENTATION OF THE STUDY PROGRAM BSc. in "COMPUTER SCIENCE"

a. Strengths:

1. Cooperation with State University of New York, Empire State College, USA, to obtain a double degree;
2. Teaching conducted in English;
3. Regular assessment of the performance of academic staff by students and colleagues;
4. The high quality of the curriculum provided for the study program based on the North American model;
5. The use of modern technology (projectors, PCs, etc.) in the teaching process;
6. A library with extensive basic and supporting literature serving the curriculum and extended access to various electronic libraries;
7. Academic staff with the appropriate qualification to develop a quality teaching process and in accordance with standards;
8. Effective management of laboratory base by the IT Office to ensure operation of computer equipment and relevant software at the service of teaching and research process.

b. Weaknesses:

1. Occasionally changes in the duration of the Bachelor of Computer Science program (dictated by the need to adapt to the evolution of legal and sub-legal acts of higher education in the country);
2. Relatively high teaching load on part of full time academic staff, making effective participation in scientific research difficult;
3. The lack of an updated market study, in accordance with the UNYT Market Research Strategy;
4. Relatively limited funding for scientific research at the service of the study program;
5. Relatively low number of students involved in research activity.

c. Opportunities:

1. Increase of the recruitment of foreign students;

2. Improvement of the image of the university with greater emphasis on research;
3. Increase of the level of participation in European projects;
4. Increase of the demand for qualitative degrees in the field of computer science;
5. Increase of the mobility of students within the European Program Erasmus +;
6. Providing services to third parties;
7. The diversification of funding sources;
8. Strengthening cooperation with local and regional universities.

d. Threats:

1. Poor level of English language in secondary schools, which causes many students not to choose to continue studying at UNYT;
2. Continuous change of the legal and sub-legal acts of higher education in Albania;
3. Relatively high tuition fee;
4. Difficulties in providing full time academic staff with the required qualification.

Recommendations

- 1) *It is recommended to conduct a detailed market study in accordance with the UNYT Market Research Strategy;*
- 2) *It is recommended that the Center for Advanced Computer Research, which is in the early stages of its consolidation, plays a greater role in increasing the scientific activity of the Faculty and putting it into service the offered study programs.*
- 3) *The teaching load of full time academic staff is generally at an acceptable level, but we recommend to reduce it in order to allow greater participation in research activity.*
- 4) *It is recommended to increase the number of students engaged in research activities.*

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm

Prof. Dr Thoma Korini

Dr. Alketa Grepcka

